XHAFER DURMISHI

TESTAMENTI

1. PRONA E PAKUFISHME DHE PRONA E KUFIZUAR
2. PRONA
2-1. Posedimi
2-2. Posedimi i menjëhershëm (ekskluziv)
2-3. Posedimi i mesëm
2-4. Bashkëposedimi
2-5. Prona e patundshme
2-6. Prona e mobile
2-7. Prona personale mobile
2-8. Pronë tjetër mobile
2-9. Teoria e vlerës së pronës
2-10. Vlera e përdorimit
2-11. Vlera e këmbimit
3. JU U BËTË PRONË E BREZAVE
4. TRASHËGIMIA
4-1. Të uroj trashëgim të frutshëm shqiptar
4-2. HUMBJA DHE FITIMI I TRASHËGIMISË
5. TESTAMENTI
5-1. Testamenti i Alfred Nobelit
5-2. Testamenti i Leninit
-Letër Kongresit
5-3. Testamenti i Ibrahim Kelmendit për Ramë Nikçin
5-4. TESTAMENTI i SHKOLLËS SË UDB-së SERBE NË EMËR TË JUSUF GËRVALLËS
5-5. Testamenti i Jusuf Gërvallës për Shkollën e UDB-së Serbe
5-6. Testamenti i Ibrahim Kelmendit për Jusuf Gërvallën
5-7. Testamenti i Jusuf Gërvallës për Ibrahim Kelmendin

6. TURBULENCA

7. ZAVENDËSI

7-1. NUK ËSHTË ZHVILLUAR KURRFARË AKTIVITETI
7-2. SPEKTAKLE DHE VRAPIME TË MJERA
7-3. SHKOLLA E UDB-së dhe, sipas Jusufit, nipi i një agjenti me zile të UDB-së
-Me Skënder Skënderin isha takuar vetëm njëherë
-Sabri Novosella e përzgjodhi Nuhi Sylejmanin
-Inferioriteti vandal i burrit të papërkulshëm
-Ishte i angazhuar në përgatitjen e Zërit të Kosovës
-Ai nuk përfillte askënd
-Po ta dija se do të afirmohesha
-Internacionalizmi proletar i udbashit "komunist" dhe hienat sllave
-Shefi i tanishëm i familjes Gërvalla
-E kemi dëshminë se si u bë trashëgimtarë
-Uzurpuesit e zotshpillakut u imponuan si trashëgimtarë
7-4. Lëvizja u shua me vrasjen e Jusuf Gërvallës
7-5. Jusuf e donte se ai ishte besnik
7-6. ASKUSH S'MUND TA ZËVENDËSONTE DHE AS MUND TA ZËVENDËSOJË JUSUF GËRVALLËN!
7-7. Lëvizja u shua një muaj pas vrasjes së Jusuf Gërvallës
7-8. Ky bashkim kishte dhënë kontribut të jashtëzakonshëm
7-9. PAS VRASJES SË TYRE KA NDODHUR AJO QË KA NDODHË PAS VRASJES SË ADEM JASHARIT
7-10. Si trim i mirë me shokë shumë

8. LUFTA PËR FRON DHE FATI I FRONTEVE

8-1 Lufta e Madhe Civile Abaside
8-2 Anarkia (The Anarchy)
8-3 Lufta për Fronin e Champagne
8-4 Lufta për Fronin e Flanders dhe Hainault
8-5 LUFTA PËR FRONIN E THURINGUT
8-6 Lufta për Fronin Bizantin 1341-1347
8-7 Lufta për Fronin e Guelders
8-8 Kriza Portugeze e viteve 1383-1385
8-9 Lufta për Fronin e Breton-it
8-10 Lufta për Fronin e Lituanisë (1431-1435)
8-11 Lufta për Fronin e Stettin-it
8-12 Lufta për Fronin e Kastiljës
8-13 Lufta për Fronin e Landshut
8-14 Lufta për Fronin e Inkas
8-15 Lufta për Fronin e Portugalisë
8-16 Lufta për Fronin e Polonisë (1587-88)
8-17 Lufta për Fronin e Jülich-ut
8-18 Lufta për Fronin Mantuan
8-19 Lufta për Fronin e Pfalzit (Der Pfälzische Erbfolgekrieg (1688–1697)
8-20 Lufta për Fronin e Spanjës
8-21 Lufta për Fronin e Polonisë (1733-1738)
8-22 Lufta për Fronin e Austrisë
8-23 Lufta për Fronin e Bayernit
8-24 Lufta rreth Fronit Miguelite

9. LUFTA PËR KARRIGA
9-1. Lufta për Karrigën numër 1
9-2. Lufta për Karrigën numër 2
9-3. Lufta për Karrigën numër 3
9-4. Lufta për Karrigën numër 4
9-5. Lufta për Karrigën numër 5
9-6. Lufta për Karrigën numër 6
9-7. Lufta për Karrigën numër 7
9-8. Lufta për Karrigën numër 8
9-9. Lufta për Karrigën numër 9
9-10. Lufta për Karrigën numër 10
9-11. Lufta për Karrigën numër 11
9-12. Lufta për Karrigën numër 12
9-13. Lufta për Karrigën numër 13
9-14. Lufta për Karrigën numër 14
9-15. Lufta për Karrigën numër 15
9-16. Lufta për Karrigën numër 16
9-17. Lufta për Karrigën numër 17
9-18. Lufta për Karrigën numër 18
10. GRACIAS A LA VIDA

1. PRONA E PAKUFISHME DHE PRONA E KUFIZUAR

Pasi më ishte dhënë porosia të marrë kontakt nga lidhja ime e Lëvizjes, më 17 korrik 1981, jam nisur me tren nga Zurichu për në Shtutgart, tek udhëheqësi shpirtëror i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi dhe personaliteti më i rëndësishëm i çështjes shqiptare në vitet 1980-1981, Jusuf Gërvalla. Peshën e vërtetë të Jusufit në çështjen shqiptare, të cilën më parë e kisha imagjinuar, e kam mësuar vetë, me shembujt konkret e me gjithë atë punë që ishte bërë nga ai, vetëm pas qëndrimit tim në Shtutgart.

Gjatë kohës si nxënës i Shkollës së Mesme Teknike "Nikolla Teslla" në Obiliq, dhe gjatë studimeve në Mitrovicë, më kishte rënë të takoj persona që kanë qenë të njohur në elitën kulturore dhe shkencore të Kosovës. Megjithatë takimi me Jusufin në kujtesën time është më i pashlyeshmi, jo vetëm për atë se kishe të bëje me një person që ishte në kulmin e kulturës dhe dijes, që populli ynë me aq mundime kishte arritur ta lind dhe ta krijoj një figurë të tillë, por edhe më tepër për faktin se ai, si asnjë tjetër nga gjenerata e mjedisi i tij në Prishtinë, kishte dalë aq fuqishëm e në mënyrë aq të plotë në barrikadat e popullit.

Në jetën time nuk e kam përjetuar asnjë rast ta ndiej veten më të pabarabartë se sa kur jam ndeshur me superioritetin e Jusuf Gërvallës. Shumë i vetëdijshëm për këtë fakt jam munduar të mësoj sa më shumë nga ai, dhe kurrë bashkëpunimin tonë nuk e kam menduar si bashkëpunim të barabartë. Me tërë qenien time, Jusuf Gërvallës nuk ia kamë lënë asnjë dilemë për atë se nuk e kam ndier veten të barabartë me te, jam munduar dhe besoj se nuk ia kam lënë asnjë dilemë, që ai ta kupton se në anën e kujt qëndroj, dhe ai e ka pasur të qartë si drita e diellit, se pas vendosjes time në Shtutgart, se ai ka qenë i vetmi epror i imi.

Duke mësuar, e duke marrë aq shumë nga prona shpirtërore, nga prona e pakufishme shpirtërore e Jusuf Gërvallës, mendoj se në këtë mënyrë, nuk kam ndërhyrë në pronën dhe në trashëgiminë (e kufizuar) që u takon fëmijëve të tij, familjes së tij të ngushtë apo të gjerë.

2. PRONA

Prona është një send-gjë konkrete individuale, fizikisht e përcaktuar (latinisht: res), e patundshme ose e tundshme, që përbënë objektin e të drejtës pronësore, të cilën pronari e posedon fizikisht, e ka pushtetin e kontrollimit përmes autorizimeve të rregulluara me ligj, të drejtës zakonore apo praktikave të krijuara nga gjykatat, duke i përjashtuar kërkesat juridike të çdo personi tjetër për të njëjtin send-gjë. E drejta pronësore (latinisht: dominum) për pronën që konsiderohet se reprezenton një vlerë të rëndësishme komerciale të këmbyeshme (vlerë në para), mundet rëndomë të regjistrohet tek një organ kombëtar shtetëror.

Pronari mundet, duke u mbështetur në të drejtën pronësore të ndërmerr masa dhe qëndrime që ai i quan të përshtatshme.

Donika Gërvalla: "*Ndërsa për fotografinë dhe aspektin artistik unë jam shumë e interesuar dhe e gatshme për një diskurs mes meje dhe teje ose mes nesh dhe personave të tjerë rreth këtyre çështjeve. Unë jam shumë e hapur së paku për të dëgjuar. Unë vërtet në fund bëj atë që mua me duket e udhës, por jam e hapur për të dëgjuar jo sa për sy e faqe por me gatishmërinë për të vënë në pyetje të gjitha pozicionet e mia që kanë të bëjnë me babain tim.*" (Letër Xhafer Durmishi, 12 maj 2007)

Pronari thuhet, se ka një të drejtë të përgjithshme të lirë të disponimit. Por, e drejta pronësore mund të kufizohet në bazë të drejtës zakonore, marrëveshjeve, praktikave që krijohen nga vendimet e gjykatave apo shprehimisht duke u thirrë në ligj.

Prona, e tundshme apo e patundshme, ka vlera të ndryshme, pjesërisht një vlerë jo-komerciale të përdorimit, dhe pjesërisht një vlerë komerciale të këmbimit.

2-1. Posedimi
2-2. Posedimi i menjëhershëm (ekskluziv)
2.-3 Posedimi i mesëm
2-4. Bashkëposedimi
2-5. Prona e patundshme
2-6. Prona e mobile
2-7. Prona personale mobile
2-8. Pronë tjetër mobile
2-9. Teoria e vlerës së pronës
2-10. Vlera e përdorimit
2-11. Vlera e këmbimit

2-1. Posedimi

Posedimi (lat. possessio) është ekskluzivisht një raport sendesh. Posedimi i referohet vetëm tek kontrolli fizik (lat. corpus) i sendeve të patundshme dhe të tundshme. Ç'rregullimi i posedimit ndodhë kur dikush tjetër e shkëputë poseduesin prej posedimit të tij ndaj sendit. Posedimi përbënë një presupozim se ai që ka në posedimin e tij një send të patundshëm apo të tundshëm është pronari legjitim i sendit. Në drejtësinë

gjermane dhe të disa vendeve tjera, njihet ekskluzivisht posedimi në raport me sende të patundura ose të tundura. Posedimi ose është i menjëhershëm ose i mesëm.

Posedimi përbën një presupozim lidhur me atë nëse një territor tokësor të njihet si pjesë e një shteti (latinisht: imperium). Nga territori tokësor rrjedh territori detar dhe ai ajror. Posedimi konsiderohet se ia jep të drejtën shtetit të ushtroj aprovimin e ligjeve, gjyqësinë dhe administrimin brenda territorit të vet (principi i efektivitetit). Shteti ka të drejtë ta mbrojë posedimin e territorit të vet kundër ndërhyrjes në posedim prej shteteve tjera. E drejta ndërkombëtare e njeh ekskluzivisht posedimin shtetëror të territoreve. Se a është një posedim legjitim apo i kundërligjshëm në raport me ndonjë shtet tjetër konkurrues është krejtësisht çështje tjetër.

Metafizika abstrakte nuk ka kuptim, dhe nuk ka referenca në botën konkrete reale, fizike. Shembull për figura të fantazisë, siç janë kentaurët. Është pra e pakuptimtë të flitet për "posedim" juridik të çështjeve abstrakte metafizike.

2-2. Posedimi i menjëhershëm (ekskluziv)

Posedimi i menjëhershëm (gjermanisht: eigenbesitz) ekziston kur poseduesi ka qasje të lirë dhe të papengueshme në gjëra që janë në kujdesin e tij, dhe kontrolli i çdo personi tjetër ndaj atyre sendeve është i prerë, i mbyllur.

2-3. Posedimi i mesëm

Posedimi i mesëm (gjermanisht: mittelbar besitz) ekziston kur poseduesi ka qasje të lirë dhe të papengueshme në sendin që e ka në përkujdesjen e tij, por në këtë rast posedimi nuk është i prerë dhe i mbyllur edhe për ndonjë person tjetër i cili gjithashtu ka qasje në ato sende që janë në përkujdesjen e poseduesit.

Shembull për këtë lloj posedimi mund të merret rasti kur një restoran ka qasje të mesme në pjatat, lugët dhe pirujt, dhe kur edhe një mysafir i ka këto në duart e tij për të ngrënë. E njejta gjë mund të thuhet për një mysafir të hotelit i cili e merr me qira një dhomë.

Ibrahim Kelmendi: *"Kur u ndanë (Ibrahim Kelmendi prej shokut të mirë e të pastër si loti, agjentit të UDB-së Sadik Blakaj dhe Hysen Gegës me rastin e nisjes së tyre për në Kosovë, më 19 dhjetor 1980-shën. i Xh. D.), Mirani shkoi te Jusufi e Bardhi. Ata ndërkohë ishin vendosur me banim në Untergruppenbach, një fshat i madh në afërsi të Hajlbronit dhe Shtutgartit. Aty kishin zënë me qira një shtëpi të re, dy katshe e gjysmë, përkatësisht dy kate dhe çati. Shtëpia e sapondërtuar po pranonte banuesit e parë. Në katin e dytë, të cilit gjermanët i thonë kat i parë, përballë përfundimit të shkallëve, ishte një dhomë e vogël rreth dhjetë metra katrore. Këtë dhomë Jusufi e kishte caktuar vetëm për Miranin. Fëmijët kishin filluar të parët t'i thoshin dhoma e Axhit Miran. Pastaj kështu kishin filluar t'i thoshin të gjithë anëtarët e Familjes Gërvalla. Kur Mirani nuk ishte aty nuk hynte njeri, meqë kështu kishte urdhëruar Jusufi." (*Atentatet, Prishtinë 2007, f.184*)*

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Pas largimit të Saimes, Suzana na ftoi **në dhomën e ndarë enkas për shokun Ibrahim Kelmendi.** Shkuam të gjithë sa kishim ngelur në familjen Gërvalla, unë, Ibrahimi dhe Xhaferi. Kam për t'ju treguar diçka tha, dhe e shpaloi palën e jorganit, duke pyet se kush nga ne i kishte fshehur ato para aty. Xhafer Durmishi shikonte pa folur, Ibrahim Kelmendi tha: „dikush i paska lënë cullak aty", kurse unë i thashë Suzanës të m'i jepte mua paratë. Pa hezitim ajo m'i dha. I numërova dhe i vendosa në arkë në prezencën e tyre. Ishin gjithsej 4.880 marka. **Paratë e fshehura u legalizuan, por pyetja se kush mund t'i ketë fshehur në dhomën ku kishte***

qasje vetëm Ibrahim Kelmendi, nuk u sqarua kurrë!" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 123-124)

Shkolla e UDB-së Serbe*: "Enigmë mbeti shuma prej 4.880 markash, e gjetur nga Suzana Gërvalla fshehur në* ***dhomën e ndarë enkas për Ibrahim Kelmendin****."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 156)

2-4. Bashkëposedimi

Bashkëposedimi (gjermanisht: mitbesitz) në sende të patundshme apo mobile ekziston në mes bashkëpronarëve, apo në mes bashkëshortëve apo atyre që në mënyrë të qëndrueshme bashkëbanojnë dhe i kanë sendet në përkujdesjen e tyre. Të dy bashkëshortët kanë obligimin e përkujdesjes për ato gjëra-sende që janë nën kontrollin e tyre dhe që janë objekt të së drejtës martesore.

2-5. Prona e patundshme

Sendet e patundshme (latinisht: res immobilis) quhen pronë e patundshme. Prona e patundshme është toka e cila është e ndarë në kadastra (estate). Kombësia tek prona e patundshme përcaktohet në bazë të asaj se ku shtrihet prona në pikëpamje gjeografike.

E drejta e pronës në pronë të patundshme regjistrohet në regjistrin e pronave (librat kadastral). Regjistrimit i paraprinë një provim i ligjshmërisë (principi i legalitetit). Ai, të cilit i shkaktohet humbje për shkak të gabimeve apo moskujdesit nga ana e organeve të regjistrimit, ka të drejtë në dëmshpërblim nga shteti.

2-6. Prona mobile

Sendet e lëvizshme (latinisht: res mobilis) quhen pronë mobile (e tundshme). Pronë mobile janë sendet që nuk janë tokë.

Kombësia tek pasuria mobile, është e lidhur-fiksuar tek e drejta e pronës, pa marrë parasysh se ku gjendet prona gjeografikisht. Që prona të konsiderohet gjermane, kërkohet që pronari i saj të person fizik apo juridik gjerman me më tepër se pesëdhjetë për qind.

2-7. Prona personale mobile (personal estate)

Sendet që mund të lëvizen-barten në mënyrë të natyrshme quhen pronë personale mobile, p.sh. letra aksionare, libreza kursimi, vetura, anije e vogël (boat), libra, vegla shtëpiake, tesha, monedha metali, monedha letre, vërtetime se të tjerët të kanë borxh etj. Pra me *personal estate* mendohet në ato sende që një person fizik mundet me i marrë me vete.

2-8. Pronë tjetër mobile

Sende të cilat nuk mund të lëvizen në mënyrë të natyrshme, p.sh. lokale të cilat gjenden në tokën e tjetërkujt, autobus, kamion, aeroplan udhëtarësh, platformë në deti për nxjerrjen e naftës apo anije e madhe transportuese (ship). Sende të lëvizshme janë ato që një person fizik nuk mund t'i merr me vete (personale estate).

2-9. Teoria e vlerës së pronës

Teoria moderne e filozofisë së të drejtës dhe shkenca e drejtësisë është e ndërtuar në themelet e logjikës së Aristotelit dhe klasifikimit të shkencës së drejtësisë nga ajo (logjika), dhe mënyrës së saj (drejtësisë) për t'iu afruar realitetit. Ndikimi i saj

në të drejtën klasike romake vjen në shprehje tek Gaius Institutiones (160 pas erës së re.).

Aristoteles (384-322 p. e.) e ka nda vlerën e pronës pjesërisht në vlerë jo-komerciale të përdorimit (për nevoja shtëpiake) dhe pjesërisht në vlerë komerciale të këmbimit (tregtia e këmbimit) në veprën Politika (1256-1259b). "Tregtia, lloji më i rëndësishëm i tregtisë së këmbimit, është ndarë në tri pjesë: ndërtim anijesh, transport dhe shitje." (1258b)

John Locke (1632-1704) ka qenë një filozof, psikolog, pedagog dhe mjek anglez. Locke ka qenë i biri i avokatit (anglisht: barrister-at-law) John Locke (1606-1661), i cili më parë e ka krijuar një pasuri familjare përmes blerjes së tokave bujqësore. John Locke e ka trashëguar babain e tij dhe nuk ka pasë probleme ekonomike gjatë viteve në vijim të jetës së tij.

Më 1690 John Locke e botn librin e tij *Two Treatises of Government* (Dy trajtesa për formën e qeverisjes). Libri përbëhet prej dy pjesëve. Pjesa e dytë, *The Second Treatise of Government,* e ka nëntitullin *An Essay Concerning the True Original, Extent, and End of Civil Government* (Një ese lidhur me origjinën e vërtetë të qverisjes civile, shtrirjes dhe qëllimeve të saj). Prona (anglisht: property) trajtohet në kapitullin 5, § 25-51.

Locke mendon se çdo njeri nga natyra është i lirë të veproj dhe të disponoj me personin e tij dhe pronën e tij. Këto të drejta natyrale mund të kufizohen tek një individ vetëm për atë, në mënyrë që edhe ndonjë tjetër individ t'i ketë po ato të drejta.

Të gjithë njerëzit lindin pjesërisht me të drejtën për liri për personin e tyre, ndaj të cilës askush tjetër nuk ka pushtet dhe pjesërisht me një të drejtë që përpara të gjithë të tjerëve ta trashëgojnë pasurinë e babait së bashku me vëllezërit e motrat e tyre. Në bazë të Locke gjendja-natyrale është një gjendje e natyrshme ku të gjithë njerëzit kanë liri të plotë për të vepruar dhe pasur në dispozicion personin e tyre dhe pronën e tyre në atë mënyrë që ata e shohin të përshtatshme, brenda kufijve të së drejtës natyrale, pa e pyetur ndonjë person tjetër për leje apo për të qenë i mvarun prej vullnetit të ndonjë njeriu tjetër.

Resurset natyrore i takojnë gjithë njerëzimit. Në gjendjen natyrale nuk ka pasur komandues privat që ka vendosur për të gjithë njerëzit tjerë. Gjithçka që e ka ushqyer një person ka qenë e tij, edhe pse gjithçka është konsideruar pronë e përbashkët. Të gjitha sendet që një person i ka marrë nga natyra, i ka përpunuar me punën e tij, dhe ka shtuar diçka nga vetja, mendon Locke, do të thotë se ai person atë send e ka bërë pronë të tij.

Asnjë person tjetër në vazhdim nuk mund të ketë të drejtë në atë send. Por asnjë person nuk ka të drejtë të merr nga natyra më tepër se sa ai ka nevojë për gjallnimin e tij. Pjesa tjetër u ka takuar të tjerëve. E njejta gjë ka vlejtë për tokën. Aq tokë sa një bujk kishte mundësi ta përpunoj, mbjellë, përmirësoj dhe t'i shfrytëzoj të dhanat e punës së tij, aq ishte edhe prona e bujkut.

Locke ka konsideruar se nënshtetasit, përmes kontratës shoqërore, kontratë e cila është lidhë në mes shtetit dhe nënshtetasve, e kanë bartur tek shteti atë pushtet, fuqi (gjermanisht: macht) që është i domosdoshëm për t'i mbrojtur të drejtat natyrore njerëzore që nga lindja, do me thënë të drejtën për jetë, shëndet, liri dhe para së gjithash pronën, kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm, por jo edhe më tepër pushtet se kaq.

William Blackstone (1723-1780) shkruan në librin e tij shkollor rreth të drejtës angleze, *Commentaries on the Laws of England, book II, Of the Rights of Things, Clarendon, Oxford 1766 ch. 1, p 2: "There is nothing which so generally strikes the*

imagination, and engages the affections of mankind, as the right of property; or that sole and despotic dominion which one man claims and exercises over the external things of the world, in total exclusion of the right of any other individual in the the universe." (Nuk ka asgjë më shumë që e venë fantazinë dhe ndjenjat në lëvizje tek njerëzit se sa e drejta për pronë; apo kur një person vetëm dhe në mënyrë despotike e ushtron kontrollin e pushtetit mbi sendet e tij fizike, me përjashtim të plotë kërkesave juridike të çdo njeriu tjetër në krejt universin.) Libri shkollor i Blackstonit në katër vëllime ka pasur rëndësi të madhe për zhvillimin e drejtësisë në vendet e Perandorisë Britanike. Librin shkollor të Blackstonit kolonistët anglez e kanë marrë me vete në Amerikë, dhe ai libër është përdorë për ndërtimin e themeleve të drejtësisë amerikane. Libri i Blackstonit "Commentaries" ka qenë një prej atyre burimeve kryesore që është përdorë kur është aprovuar Kushtetuta e SHBA. Edhe sot, Gjykata më e lartë federale në SHBA i referohet librit të Blackstones "Commentaries" në arsyetimet e vendimeve të veta.

Sistemi i vjetër i të drejtës natyrore franceze (l' ancien régime) ka qenë deri në vitin 1804 një kaos prej rreth 360 librash ligjore që e ka bërë pothuajse të pamundur orientimin e shpejt. Në deklaratën franceze mbi të drejtat e njeriut, që niset nga pikëpamja liberale për të drejtën natyrore, nga viti i revolucionit, 1789, në artikullin 17, thuhet se: "Pasi e drejta në pronë është një e drejtë e pacënueshme dhe e shenjtë, ajo nuk mund t'i merret askujt, po që se nuk është e domosdoshme për ta plotësuar një nevojë të përgjithshme, të konstatuar dhe ligjore, dhe bëhet pas një kompensimi paraprak dhe të arsyeshëm." Libri i të drejtës natyrale liberale civile i Napoléon Bonapartes (1769-1821) Code Civil nga viti 1804, përmban 2 281 artikuj të ndarë në tre libra. E drejta e sendeve (frengjisht: des bien) trajtohet në librin e dytë, artikujt 510-710, ku në pikat kryesore është i inkorporuar artikulli 17 i deklaratës së vitit 1789 dhe e vulosë pacënushmërinë e së drejtës në pronë. Code Civil i vitit 1804 me rregullat e tij materiale ka qenë i shkruar për shoqërinë e atëhershme bujqësore të Francës. Kuptimi francez liberal i së drejtës natyrore që vjen në shprehje në të drejtën franceze, gjendet në bazën e Unionit Evropian dhe raportet e tij interne rregullohen sipas të drejtës administrative franceze.

Socialisti utopist francez Pierre Joseph Proudhon (1809-1868) reagon në mënyrë radikale kundër pohimit se "e drejta në pronë është një e drejtë e pacënueshme dhe e shenjtë", dhe e zhvillon teorinë e tij të vlerës në librin *Systèmes des contradictions économiques, ou philosophie de la misère*, në dy vëllime, në vitin 1846. Proudhon e thotë shprehjen e tij të famshme "prona është hajni". Ajo çka është edhe më interesante, është se Proudhoni e shtron pyetjen "çka është prona?" Proudhoni analizon në librin e tij vlerat e dyfishta të pronës, atë jo-komerciale, të përdorimit dhe atë komerciale, të këmbimit.

Karl Marx (1818-1883), nën ndikimin e Proudhonit, i zhvillon vlerat e dyfishta të pronës, atë jo-komerciale, të përdorimit dhe atë komerciale, të këmbimit, në librin e tij Kapitali libri i parë, pjesa e parë, kapitulli i parë. "Malli para së gjithash është një send i jashtëm, send, i cili përmes vetive të tij plotëson nevoja njerëzore të ndonjë lloji. Karakteri i këtyre nevojave, se a e kanë shkakun tek barku apo fantazia, nuk ndryshon asgjë në thelb. Gjithashtu nuk është çështje se në cilën mënyrë sendi e plotëson nevojën njerëzore, të menjëhershme si artikull ushqimor, apo si artikull përdorimi, apo përmes ndonjë rruge anësore, si mjet prodhimi."

2-10 Vlera e përdorimit

Vlera e përdorimit është kualiteti jo-komercial, përjetimi i përdorimit praktik, i përdoruesit individual që të ketë mundësi t'i përdorë vetitë individuale të pronës. Kualiteti i pronës është i pamvarun nga pozita gjeografike e pronës.

2-11. Vlera e këmbimit

Vlera e këmbimit është ekskluzivisht vlerë në para, kuantitative, komerciale tek prona individuale që shfaqet kur ajo këmbehet me një pronë tjetër, dhe shprehet në çmimin e këmbimit që krijohet aty. Vlera këmbyese e pronës, rëndomë shprehet në një vlerë parash. Vlera e këmbimit është vlera që mund të matet në mënyrë kuantitative, për ndryshim nga vlera e përdorimit, tek e cila kjo matje nuk është e mundur.

Jusuf Gërvalla: "*Mbi idetë dhe lëvizjet përparimtare asnjë popull nuk mund të vërë dorë përgjithmonë, ashtu si e vë njeriu kësulën në kokën e vet të patjetërsueshme. Ku zënë fill, nga shtegtojnë dhe ku ngrehin çerdhe lejlekët e anës së ndriçuar të vetëdijes së Planetit, është punë që nuk mund të hetohet jashtë ligjshmërisë dialektike; Dhe, kjo ligjshmëri, për të paditurin, shfaqet përplot pusi.*" (Lajmëtari i lirisë, tetor 1980, f. 4)

3. JU U BËTË PRONË E BREZAVE

17 Janari i vitit 82 do të jetë një datë historike për të cilën brezat e ardhshëm do të mësojnë nëpër shkolla. Do të mësojnë se në këtë mbrëmje, në mënyrën që i karakterizon vrasësit më barbarë, u vranë Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla.

E shënuar do të jetë kjo ditë për punëtorët në mërgim, ditë në të cilën ne u ndamë nga vëllezërit tanë. Neve këtej na nxorën regjimet që shtypin klasën punëtore, na nxorën këtej duke na thënë se nuk kemi kualifikime në mënyrë që këtu të punojmë punët më të vështira dhe me krahun tonë t'i sigurojmë Jugosllavisë së molisur devizat me të cilat ajo po i paguan UDB-ashët e vet për të vrarë bijtë tanë.

Këta pasi u shpëtuan arrestimeve të para disa viteve, erdhën në mesin tonë për të na ndihmuar që të njohim më mirë fajtorin e të gjitha të këqijave tona. Disa nga ne, në fillim mendonim se a do të dimë të merremi vesh me shkollarët tanë. Por shumë shpejt e kuptuam njëri tjetrin. Morëm vesh se këta kalonin netë të tëra pa gjumë vetëm që të na afronin sa më tepër. U lidhën me ne, shtresat më të gjëra të popullit sepse na u afruan si vëllezër e si shokë. Pranuan me ne biseda të hapura e na i dëgjuan fjalët tona edhe kur nuk ishin me vend, me durim të madh. Na thirrën në demonstrata dhe ne u përgjigjëm njëzëri. Dolëm në demonstrata jo pse na paguan me marka si rrenin shovinistët e Beogradit, por pse në fjalët e tyre e pamë të vërtetën. Ata me gjithë shpirtin u mbështetën tek ne.

Ata ishin të thjeshtë e të gatshëm të bisedonin me të gjithë. Vinin tek ne darkave e pasdarkave e bisedonin kokë më kokë me ne për problemet e punës, për familjet e për të rejat nga Kosova. Lajmet e shkëputura që ua sillnim ne nga Kosova, ata na i jepnin të shtypura në faqe gazetash. Nuk përtonte Bardhoshi ta merrte çiftelinë e Jusufi t'ia thoshte këngës nëpër dhomat tona e nëpër manifestime të ndryshme, e të na bëjnë për disa çaste t'i harrojmë vuajtjet e në fytyrat tona të dukej buzëqeshja. Po ta japim fjalën shoku Jusuf se edhe pse çiftelisë nuk dimë t'i biem, kënga "Për mëmëdhenë" nuk do të pushojë kurrë.

Nuk do ta harrojmë as zërin tënd nga megafoni shoku Zeqë, me të cilin na përcolle nga demonstrata në demonstratë.

U njohëm me ju në kurbet, dhe ne na lidhën fortë fatet e njëjta. Fjalët tuaja të thëna me gojë si dhe ato të shkruara do t'i kujtojmë dhe do t'i ruajmë me kujdesin më të madh. Ju kemi lakmi juve dëshmorë, për veprën e madhe, ndërsa tek prindërit tuaj

shohim fytyrën e vërtetë të nënës e të babait shqiptar, të cilët na duket se kanë dalur nga këngët kreshnike dhe legjendat, e qëndrojnë këtu mes nesh.

Ju sigurojmë, ashtu siç keni qenë edhe ju të sigurt, se familjet tuaja do t'i rrethojë tërë populli, e kujtimin tuaj do ta ruaj thellë në gji.

Çdo kush prej nesh krenohet me shumë të drejtë, sepse patëm rastin që për një kohë shumë të shkurtër qëndrimi me ju, mësuam aq shumë për historinë e popullit, për luftërat që kemi pasur dhe ajo që është më e rëndësishmja për luftërat që na presin. Me të vërtetë ne kemi një pasuri të madhe, të cilës do t'ia kanë zili brezat e ardhshëm. Nëse neve me arsye na shkon mendja, nga emocionet, të kishim qenë bashkëluftëtarë të Skënderbeut, të kishim qenë në njësinë e Mic Sokolit, të ndodheshim afër Bajram Currit në shpellën e Dragobisë, foshnjet e sotme nesër do të thonë: Të ishim bashkëpunëtorët e bashkëluftëtarët e këtyre trimave.

Nesër kur historinë do ta nxjerrim në dritë ju do të bëheni pasuri e brezave.

Nesër në ditën e lirisë, toka e lirë shqiptare do t'u thërret ashtu siç thirri Abdylin, Gurakuqin, Naimin, Hasanin etj. Derisa të vijë ajo ditë varrezat tuaja këtu do të jenë vend i shenjtë për të gjithë shqiptarët jashtë atdheut. Nga vizitat që do t'u bëjmë do të mbushemi me frymëzime dhe do të betohemi se do të vazhdojmë luftën deri në realizimin e idealeve tona të përbashkëta.

LAVDI DËSHMORËVE!

Ky fjalim i shkruar nga Xhafer Durmishi u lexua me rastin e varrimit të vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës, më 5 shkurt 1982, nga Remzi Ademaj. (Zëri i Kosovës, mars 1982, faqe 7-8)

4. TRASHËGIMIA

Trashëgimia është tradita për t'ia përcjellur më tutje pronën, titujt, borxhet dhe detyrimet kur një individ vdes.

Trashëgimia përmes lidhjes së gjakut një kohë të gjatë ka luajtur rol të rëndësishëm në shumë shoqëri. Traditat dhe ligjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë mund të kenë ndryshime prej vendi në vend e gjithashtu prej kohe në kohë. Në bazë të së drejtës së vjetër gjermane, prona është trashëguar në bazë të lidhjes farefinsore. Testamentet kanë qenë pothuaj krejtësisht të panjohura dhe trashëgimia është lidhur vetëm në bazë të lidhjes farefisnore pa marrë parasysh se a ka qenë kjo lidhje e afërme apo e largët.

Në bazë të së drejtës romake, lidhjes farefinsore nuk i është kushtuar e njëjta rëndësi dhe prona i është përcjellur dikujt, përmes testamentit, shpeshherë vetë Cezarit.

4-1. Të uroj trashëgim të frutshëm shqiptar

Jusuf Gërvalla: *"I dashur shoku Z.!*

Para disa ditësh e mora videokasetën e pritur. Në të janë pesë filma e drama shqiptare të shkëlqyeshme. Shfaqjet e tyre të para ndër punëtorët tanë, treguan se janë shumë frymëzues. Ne ende nuk arritëm t'i shumëzojmë e t'jua dërgojmë edhe juve, sepse po na mungon edhe një videofon i dytë. ...

Njëherazi shfrytëzoj rastin t'ju përgëzoj edhe njëherë për martesën dhe t'ju uroj trashëgim të frutshëm shqiptar.

Me përshëndetje revolucionare
Drini" (Letër Kadri Zekës, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 284-285)

4-2. HUMBJA DHE FITIMI I TRASHËGIMISË

Anëtari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Sabri Hamiti, ka shkruar dramën *Misioni* (Prishtinë 1997) që ka të bëjë me Jusuf Gërvallën dhe familjen e tij. Fjalia e mëposhtme, e të bijës së Jusufit, është marrë nga kjo dramë.

Sabri Hamiti: "DONA- Ai për mua kishte humbur në Gjermani." (Misioni, f.88-89)

Jusuf Gërvalla: "Mbi idetë dhe lëvizjet përparimtare asnjë popull nuk mund të vërë dorë përgjithmonë, ashtu si e vë njeriu kësulën në kokën e vet të patjetërsueshme. Ku zënë fill, nga shtegtojnë dhe ku ngrehin çerdhe lejlekët e anës së ndriçuar të vetëdijes së Planetit, është punë që nuk mund të hetohet jashtë ligjshmërisë dialektike; Dhe, kjo ligjshmëri, për të paditurin, shfaqet përplot pusi." (Lajmëtari i lirisë, tetor 1980, f. 4)

S. H: "DONA- Ai për mua kishte humbur në Gjermani." (Misioni, f.88-89)

Jusuf Gërvalla: "Ky burrë i shtrenjtë i dijes shqiptare tërë jetën ia kushtoi shkencës dhe kulturës kombëtare dhe na la trashëgim një vepër monumentale me karakter enciklopedik. Përveç shkrimeve me interes për kritikën letrare, për historinë e letërsisë, folklorin, etnografinë, historinë etj. Eçrem Qabej trajtoi e zgjidhi çështje nga më të rëndësishmet në të gjitha fushat e gjuhësisë; ortografi e fonetikë, filologji e gramatikë, dialektologji e fjalëformim, leksikografi e leksikologji, onomastikë e etimologji, sidomos në historinë e gjuhës." (Lajmëtari i lirisë, tetor 1980, f. 7)

S. H: "DONA- Ai për mua kishte humbur në Gjermani."

Jusuf Gërvalla: "Por, përjetë do të përulemi me nderime e dashuri para trashëgimisë kolosale kulturore që na la ky (Eçrem Qabej – shën. i Xh. D.) vigan i dijes dhe para kujtimit të personalitetit të tij të ndritur." (Lajmëtari, tetor 1980, faqe 8)

S. H: "DONA- Ai për mua kishte humbur në Gjermani."

Jusuf Gërvalla: "Ndonëse Lidhja Shqiptare e Prizrenit u shua me gjak- për lavdinë e shqiptarëve sypatrembur e të lidhur ngushtë si një trup dhe për turpin e fqinjëve ballkanikë dhe të shteteve evropiane, që kaluan në anën e pushtuesit shekullor turk dhe të interesave shoviniste të Rusisë së largët – ajo la trashëgim një program serioz revolucionar, vetëdijen e zgjuar kombëtare dhe shpirtin e paepur luftarak të popullit shqiptar." (Lajmëtari i lirisë, janar 1981, f. 3)

S. H: "DONA- Ai për mua kishte humbur në Gjermani."

Jusuf Gërvalla: "Duke ruajtur dhe duke kultivuar cilësinë fisnike të lëvizjes, ne do ta ruajmë dhe do ta kultivojmë në shkallë të lartë prirjen elementare të shoqërisë njerëzore – ecjen përpara, të cilës i bëhen prag me qëllime shtypëse e shfrytëzuese

forcat e errëta të planetit, kapitalizmi, imperializmi dhe revizionizmi. Dhe këtë natyrë fisnike t'ua lëmë trashëgim brezave të ardhshëm!
LAVDI MARKSIZËM – LENINIZMIT!" (Luftë të dëshpëruarish, apo lëvizje të ndërgjegjshme?, dorëshkrim)

S. H: "DONA- Ai për mua kishte humbur në Gjermani." (Misioni, f.88-89)

Jusuf Gërvalla: "Mbi idetë dhe lëvizjet përparimtare asnjë popull nuk mund të vërë dorë përgjithmonë, ashtu si e vë njeriu kësulën në kokën e vet të patjetërsueshme. Ku zënë fill, nga shtegtojnë dhe ku ngrehin çerdhe lejlekët e anës së ndriçuar të vetëdijes së Planetit, është punë që nuk mund të hetohet jashtë ligjshmërisë dialektike; Dhe, kjo ligjshmëri, për të padituri, shfaqet përplot pusi." (Lajmëtari i lirisë, tetor 1980, f. 4)

*
* *

Dhetë, nandë, tetë, shtatë, gjashtë, pesë, katër, tre, dy, nji
Udhë e mbarë, Shqiponjë e dashtun, plot me shend
Na trego, në planete tjera a kish vend
Për ca qenje t`padjallëzueme siç jemi ne?

5. TESTAMENTI

Teste'ra (latinisht: testa 'ri, nga te' stis dëshmitar) paraqitja me shkrim e vullnetit të fundit. Një testament është një dokument juridikisht i detyrueshëm, të cilin një person e shkruan për të vendosur se si pasuria që ai e lenë duhet të rregullohet-ndahet pas vdekjes së tij. Autori i testamentit quhet testator (maskulinum) ose testatrix (femininum).

Testamenti e ka origjinën e tij tek e drejta romake dhe në Perandorinë Romake, ai ia ka dhënë mundësinë elitës së shoqërisë ta shpërndaj pasurinë e vetë në një mënyrë tjetër prej asaj të lidhjeve farefisnore. Ka zgjatur shumë kohë derisa testamentet janë pranuar në vendet gjermane, pasi aristokratët dhe bujqit kanë dashur që pronat të mbahen brenda farefisit.

Kisha e ka përkrah njohjen e testamenteve, pasi këto do të kishin mundësi t'i japin shtesa për veprimtarinë e saj.

Testamenti (në kuptimin teologjik) ka të bëjë me bashkimin (marrëveshjen) në mes Zotit dhe njerëzve; emërtim për dy pjesët e kryesore të Biblës. Testamenti i vjetër (latinisht: Testamen 'tum ve 'tus) ato libra që janë shkruar para lindjes së Krishtit. Testementi i ri (Testemen 'tum no 'vum), ato libra që janë shkruar pas lindjes së Krishtit.

5-1. Testamenti i Alfred Nobelit

Në aspektin ekonomik, Testamenti i shkencëtarit dhe sipërmarrësit suedez Alfred Nobel (1833-1896) ndoshta është testamenti më i njohur në botë.

Në testamentin e tij, që mban datën 27 nëntor 1895, Alfred Nobel vulosë vullnetin e tij, që nga pasuria e tij të themelohet një fondacion, dhe renta e kësaj pasurie të ndahet si çmim për persona që në vitin paraprak i kanë sjellë më së shumti dobi

njerëzimit. Farefisi ka marrë vetëm 0,5 përqind nga trashëgimia e tij. Nobeli ka pasë atë mendim se trashëgimet i pasurive të mëdha ndikojnë në rritjen e përtacisë së fisit njerëzor.

Çmimi do të ndahej në pesë pjesë të barabarta në këto fusha:
Letërsi. Fituesi i çmimit caktohet nga Akademia Suedeze (Svenska Akademien)
Fizik. Fituesi i çmimit caktohet nga Akademia Mbretërore e Shkencave e Suedisë
Kimi. Fituesi i çmimit caktohet nga Akademia Mbretërore e Shkencave e Suedisë
Fiziologji ose Medicinë. Fituesi i çmimit caktohet nga Karolinska institutet
Punë në shërbim të paqes. Fituesi i çmimit caktohet Komiteti Nobel i Norvegjisë.

Fondacioni Nobel, që nga viti 1901, për çdo viti i ka nda këto çmime në ditën e vdekjes së Alfred Nobelit, më 10 dhjetor.

5-2. Testamenti i Leninit

Në aspektin politik, një prej testamenteve më të rëndësishme janë ato letra e shënime që kanë marrë emrin "Testamenti i Leninit".

Testamenti i Leninit është emri që i është dhënë në një dokumenti të shkruar nga Vladimir Lenini në javët e fundit të vitit 1922 dhe në javën e parë të 1923. Në testament, Lenini propozon ndryshime në strukturën e organeve qeverisëse Sovjetike. Ai gjithashtu bënë komente për anëtarët kryesor të udhëheqjes Sovjetike dhe sugjeron që Josif Stalini të largohet nga posti i tij si Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Lenini donte që testamenti të lexohet në Kongresin XII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik që do të mbahej në prill të vitit 1923. Megjithatë, pas goditjes së tretë (pikës në tru) që pëson Lenini në mars 1923 mbetet i paralizuar dhe i paaftë për të folur, testamenti u mbajt sekret nga gruaja e tij, Nadezhda Krupskaya, me shpresë për rimëkëmbjen eventuale të Leninit. Vetëm pas vdekjes së Leninit më 21 janar të vitit 1924, ajo ia dorëzon dokumentin Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste, dhe kërkon që ai t'u bëhet i njohur dhe të vihet në dispozicion për delegatët e Kongresit XIII, që do të mbahej në maj 1924.

Këtu më poshtë është një pjesë e Testamentit të Leninit:

Letër Kongresit

Unë seriozisht do të këshilloja që një varg ndryshimesh në strukturën tonë politike të bëhen gjatë këtij kongresi.

Unë dëshiroj t'ua komunikoj ato pikëpamje që unë i konsideroj më të rëndësishmet.

Në radhë të parë e vendosi çështjen e rritjes së numrit të anëtarëve në Komitetin Qendror me disa dhjetëra apo thënë edhe më qartë, me njëqind. Unë mendoj se Komiteti ynë Qendror pa një reformë të tillë do të kanosej prej rreziqeve të mëdha, në rast se zhvillimi i ngjarjeve nuk do të bëhej krejtësisht i favorshëm për ne (dhe në një zhvillim të favorshëm ngjarjesh nuk mund të llogarisim).

Më tej, dua t'i propozoj Kongresit, që me disa kushte, vendimin e Komisionit të Planifikimit Shtetëror ta njeh me karakterin e një ligji, dhe në këtë kuptim, deri në njëfarë shkalle dhe me disa kushte të veprohet ashtu siç ka kërkuar shoku Trocki.

Sa i përket pikës së parë, do me thënë një rritjeje të numrit të anëtarëve të Komitetit Qendror, mendoj se kjo është e domosdoshme, si për ta ngritur autoritetin e Komitetit Qendror ashtu edhe për atë që ne të kemi mundësi të punojmë për ta

përmirësuar rrënjësisht aparatin tonë dhe për të bërë parandalimin e dukurisë ku konfliktet në mes pjesëve të vogla të Komitetit Qendror do të kishin efekt dhe ndikim të tepruar për ardhmërinë e krejt Partisë.

Unë mendoj se Partia jonë ka të drejtë që nga klasa punëtore të kërkoj 50-100 anëtarë të Komitetit Qendror dhe klasa punëtore të ketë mundësi të na i jep këta pa i ngarkuar së tepërmi resurset e saj.

Një reformë e tillë do ta shtonte në mënyrë të dukshme stabilitetin e partisë sonë dhe do ta lehtësonte luftën e saj në rrethimin prej shteteve armiqësore, luftë e cila sipas mendimit tim në shkallë të madhe do të ashpërsohet gjatë këtyre viteve të ardhshme, më të afërta. Unë mendoj se stabiliteti i Partisë sonë do të forcohej me mijëra herë përmes një mase të tillë.

Lenin

Më 23 dhjetor 1922

Vazhdim i shënimeve

Pasi që është bërë sekretar i përgjithshëm, shoku Stalin ka koncentruar në duart e tij pushtet të pakufishëm, dhe unë nuk jam i sigurt se ai do ta përdorë këtë pushtet me kujdes të mjaftueshëm. Në anën tjetër dallohet shoku Trocki, siç është rasti me luftën e tij kundër Komitetit Qendror rreth çështjes mbi Komisariatin Popullor për hekurudhat, jo vetëm me një talent të jashtëzakonshëm. Personalisht ai ndoshta është anëtari më i talentuar i Komitetit Qendror të tanishëm, por ai gjithashtu i ka një vetësiguri të tepruar dhe ju kushton tepër rëndësi anëve administrative të çështjeve.

24 dhjetor 1922

Shtojcë e letrës së 24 dhjetorit 1922

Stalini është tepër i vrazhdë, dhe kjo mangësi, që është krejtësisht e tolerueshme brenda mesit tonë, në raportet në mes nesh komunistëve, nuk mund të tolerohet tek sekretari i përgjithshëm. Për këtë arsye u propozoj shokëve që ta gjejnë një mënyrë për ta larguar Stalinin nga ky post dhe për atë vend të zgjedhin një person tjetër, i cili mund t'ia kaloj Stalinit vetëm në një aspekt, pra të jetë më tolerant, më lojal, më i sjellshëm, më i vëmendshëm, më pak kapriçioz. Kjo rrethanë mund t'ju duket një imtësi e parëndësishme. Por duke pasë parasysh parandalimin e përçarjes dhe duke u bazuar në atë se çka kam thënë më parë për raportin në mes Stalinit dhe Trockit, mendojë se nuk është një imtësi, apo është një aso lloj imtësie që mund të fitoj rëndësi vendimtare.

Lenin

Shënimet u mbajtën nga L F

Më 4 janar 1923

(Publikimi i parë: Më 1956 në *Kommunist* (Nr. 9)
Burimi: Lenin Collected Works, Volume 36 (p. 593-611)

5-3. Testamenti i Ibrahim Kelmendit për Ramë Nikçin

Nëntitujt dhe përmbajtja e njësive "Çdo të thotë fjala vojvodë?" dhe "Kush është vojvoda Ramë Nikçi?" janë marrë nga shkrimi i Ibrahim Kelmendit me titull " KLIKA E BEOGRADIT – Të vret natën, të këndon ditën..." në 6 faqe të formatit A5, i shpërndarë në maj 1982, në emër të "Punëtorët shqiptarë në mërgim". Fillimi i citatit:

"Ç'do të thotë fjala v o j v o d ë ?

Vojvodë është gradë ushtarake në mbretërit serbe e malazeze. Këtë fjalë do ta gjejmë të sqaruar në "ilustrovana politika" të Beogradit. Por për çudi, kur klika serbomadhe ka ndërmarrë fushatë histerike kundra "nacionalizmit romantik" shqiptar, si nuk u bie fjala vojvodë në sy, që nuk ka të bëj vetëm me nacionalizmin serb. Për këtë nuk kanë frikë as gazetari shovenist Zec as vojvoda Ramë, që e përdorin me krenari.
"... Vojvoda rugovas, shkruan "ilustrovana politika" (më 26.05.81), është përfaqësuesi i tanishëm "lozës" (serbisht: loza), e cila që nga kohërat turke ruan qetësinë dhe paprekshmërinë e Patriarkanës...)
Siç na del, vojvodët kanë qenë rojë e rendit, ndërsa vojvodët e familjes Nikçi (nga Shtupeçi i Madh, fshat i Rugovës) kanë qenë rojë besnike e Patriarkanës, të ndërtuar nga Dushani, për ta përjetësuar robërinë e "stara Serbisë" (siç e quajnë shovenistët Kosovën.).

-Kush është vojvoda Ramë Nikçi?

Të shkruajmë se kush është vojvoda Ramë Nikçi nuk e kemi vështirë, pasi ai vetë na e ka lehtësuar këtë, duke përmbledhur historinë e vetë e të familjes në bisedën dhënë "ilustrovana politikës" së Beogradit, Nr. 1177, të 26.05.81. Pos kësaj bisede, ai në rrethin e Pejës është ndër më të kompromituarit. Sa ai është edhe vetëm udbashi rankoviçevës Bajram Dreshi. Të dy së bashku, me ca të tjerë, Rugovës ia njollosin emrin e pa njollosur, pse bijtë e bijat i dalin asaj zot.

Në artikullin e revistës në fjalë, "Besa nije vraçena" lexojmë:

"Ramë Nikçi është shef i shërbimit juridik ndërkomunal pranë Entit për Inkuadrim në Pejë..." Siç e pamë më lartë, është përfaqësuesi i tanishëm i "lozës" për ta mbrojtur Patriarkanën.

Në pyetje të gazetarit, se a ka marrë pjesë ndonjë rugovas në demonstrata "nacionaliste", vojvoda përgjigjet: "Po. Të tillëve ju takon sipas ligjit nga qeveria, kurse nga rugovasit – bojkotimi (izolimi). Në shtëpitë s'do hynë askush, dërisa Pleqësia jotë të mos vendos ndryshe. Nga vllazëria ime Nikçi nuk ka asnjë demonstrues. E kam vërtetuar dhe për këtë jap fjalën. Askush nga anëtarët e SHKA "Rugova" s'ka marrë pjesë në demonstrata. Më është bërë qefi..." Pastaj vazhdon vojvoda: "Ishim dy herë si shoqëri mysafirë në RPS të Shqipërisë. Këtë vit shqiptarët është dashur të na e kthejnë vizitën, por le të mos vinë..." Më poshtë vijon vojvoda: "... Çka u duhet këtyre demonstruesve që kërkojnë t'i bashkangjiten Shqipërisë (...). Këtë liri, siç e kanë shqiptarët në Jugosllavi, nuk e kanë patur asnjëherë askund dhe secili që mendon ndryshe – është njeri i keq..."

Gazetari pyet: "Babën tëndë, gjithashtu vojvodë rugovas, e kanë vrarë në pritë në vitin 1939. Kush dhe përse?"

Ramë vojvoda përgjigjet: "Kanë vrarë babën tim me dy mixhallarë, para syve të mij, brenda gjysmë ore. Ka qenë larje llogarish me fiseve, nuk ka qenë hakmarrje gjaku. U ka penguar (menohen "vrasësit") pse baba ka qenë vojvodë rugovas, që ka ruajtur (nënvizimi ynë) Patriarkanën e Pejës..." Pastaj vojvoda vijon me nostalgji çetnike:

"... Me konakun e vjetër të kishës m'është djegur edhe dhoma në të cilën kam banuar prej 1941-tës e dëri në mbarim të Luftës. Në të ka qenë kërveti, në të cilin kam fjetur, aty ka qenë edhe luga me të cilën kam ngrënë dhe fotografitë e t'parëve të mij. Të gjitha janë djegur..."

Artikulli mbaron me fjalët e vojvodës Ramë: "Unë i dua (nënvizimi ynë) shumë fjalët e Mark Milanit..." (Ato s'po i citojmë – Shtojmë se Mark Milani ka qenë

komandant i forcave pushtuese malazeze, në luftë për t'i pushtuar Plavë, Gusi, Hot, Grudë e Rugovë...).

E cituam si shumë artikullin në fjalë pse u pa e arsyeshme përmes të kësaj reviste çetnike, gjegjësisht përmes fjalëve të vojvodës, ta njohim udhëheqësin e SHKA "Rugova", i cili, sipas "Pravosllavjes" (Gazetë kishtare serbe", "kur ka parë konakun në flakë ka qa." Vojvoda kësaj radhe "demanton" atë çka ka shkruar "Pravosllavja", duke thën se rugovasit nuk qajnë kur t'u ndodhin fatkeqësi të rënda...

"Patriotizmi" serb i Ramë vojvodës, siç na bind ky artikull dhe profesioni i tij si vojvodë, ia kalon "patriotizmit" serb të shumë çetnikëve, të cilët nuk kanë bërë dhe s'do bëjnë aq sakrifica për ta mbrojtur kishën, sa bëri familja Nikçi (nga Shtupeqi i Madh). Krenaria e Ramë Nikçit si vojvod... për ta mbrojtur Patriarkanën...!!

Duket së nana e Ramës kur ka dashur të kryen nevojë (me nder me then) në vend të m... ka pjellur rastësisht vojvodën..." (Mbarimi i citatit)

Nëntitujt dhe përmbajtja e njësive "Çdo të thotë fjala vojvodë?" dhe "Kush është vojvoda Ramë Nikçi?" janë marrë nga shkrimi i Ibrahim Kelmendit me titull " KLIKA E BEOGRADIT – Të vret natën, të këndon ditën..." në 6 faqe të formatit A5, i shpërndarë në maj 1982, në emër të "Punëtorët shqiptarë në mërgim"

5-4. TESTAMENTI i SHKOLLËS SË UDB-së SERBE NË EMËR TË JUSUF GËRVALLËS

Shkolla e UDB-së: "*Me Skënder Skënderin isha takuar vetëm njëherë në familjen Gërvalla, në shtator të vitit 1981, në prezencën e Islam Rafunës. Pastaj, as nuk e kam parë, por as nuk kam dëgjuar më për të. Nuk e mora vesh se nga erdhi, nga Kosova apo nga ndonjë vend tjetër, ndodhej ilegal në Gjermani, apo kishte ndonjë leje qëndrimi. Në fillim mendova se qëllimi i vizitës së tij ishte ngushëllimi, por pak kohë më vonë, për befasinë time, Suzana ma prezantoi si „zëvendës“ të Jusufit!"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 88)

Shkolla e UDB-së: "*Kurrë nuk e mora vesh në kishte pasur të drejtë Jusuf Gërvalla, që në grahmat e fundit të jetës së* ***tij më përzgjodhi mua*** *për t'u përkujdesur për gjënë më të shenjtë që e ka njeriu në jetë, familjen, apo pati të drejtë Xhafer Durmishi të shpallej apo të vetëshpallej si zëvendës i tij pas vdekjes! Një gjë është e qartë: para se të vdiste Jusuf Gërvalla, nuk i ishte kujtuar askujt të kishte lënë ndonjë amanet që njëfarë Xhafer Durmishi duhej ta zëvendësonte atë pas vdekjes!?"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe150)

5-5. Testamenti i Jusuf Gërvallës për Shkollën e UDB-së Serbe

Në kryeartikullin e Jusufit me titull "T'I JAPIM SHTYTJE TË RE LUFTËS", i cili u lexua nga Jusufi në mbrëmjen e 28 Nëntorit, në rrethin e Shtutgartit, pos tjerash, thuhet:

Jusuf Gërvalla*: "Karshi zhvillimit të tillë të ngjarjeve, për forcat tona të organizuara patriotike e revolucionare, për rininë dhe popullin tonë dalin detyra serioze, të barasvlershme me përpjekjet historike shekullore për ekzistimin e kombit shqiptar në tërësi dhe për këmbënguljen në realizimin e të drejtave të ligjshme të pjesës së robëruar të popullit tonë nga shovinistët jugosllavë, në veçanti.*

Po të kihet parasysh pesha historike e situatës aktuale, një detyrë prioritare del bashkimi optimal i organizatave e grupeve komuniste, patriotike dhe revolucionare, të

cilat luftën kombëtare dhe shoqërore të popullit tonë të shumëvuajtur e marrin në tërë seriozitetin e saj. Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e 'politikës së madhe', lojën e arrivizmit revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh megalomanë, dhe ***ato që janë organizuar prej ELEMENTESH TË DYSHIMTA****, (këto fjalë të nëvizuara i drejtohen ish-inspektorit të UDB-së Abdullah Prapashtica - shën im) e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar. Gjaku i derdhur, burgu i zi dhe terrori çnjerëzor që po ushtron mbi bijtë e bijat e Kosovës trime, na obligon që Atdheut tonë t'i dalim hakut me një dashuri që bëhet, - siç thotë ... - me ngut, me alarm, me përpjekjet mbinjerëzore të luftëtarëve të vërtetë të lirisë."* (Zëri i Kosovës, nr. 2 janar 1982, faqe 2, shtylla 2)

Kah i erdhi Jusufit mendimi me e përdorë fjalinë *"dhe ato që janë organizuar prej* ***ELEMENTESH TË DYSHIMTA"***?

Pas mesit të nëntorit 1981, Sabri Novosella e njofton Jusufin se në Turqi, në shtëpinë e tij, është takuar me "komunistin", ish-inspektorin e UDB-së Serbe Abdullah Prapashtica, me sekretarin dhe nipin e tij. Në bazë të fjalëve të Abdullahut, Sabriu e njofton Jusufin se:

- Motivi i ish-inspektorit të UDB-së për largim nga Jugosllavia është bashkimi i të gjitha grupeve e organizatave, pasi çështja e bashkimit nuk i paska ra askujt ndërmend para tij,

-Partia "Komuniste" e ish-inspektorit të UDB-së është organizatore e demonstratave të vitit 1981,

...Po një gënjeshtër është mbi të tjerat, kur thua, si i pafytyrë që je....se JUSUFI I MADH të paska lënë ty zëvendës, të paska lënë ty amanet...të bëhesh ti kryetar!?? Po kush ishe ti ore, që të zëvendësoje Jusuf Gërvallën??? Ti nuk i afroheshe kurkund Jusuf Gërvallës, or qyqar! Në të gjithë shqiptarinë nuk ka një, që e zëvendëson Jusufin mor i mjerë, po si e sajove atë rrenë or dallkauk?! Pra DIJE MIRË, megjithëse jam i bindur që e di se, JO KURRË... AS TI E AS KUSH TJETËR, NUK MUND TA ZËVENDËSONTE E AS MUND TA ZËVENDËSOJË JUSUFIN E MADH!!! Jusuf Gërvalla nuk u sëmur.... nuk u dergj në shtratin e vdekjes, që të të linte ty amanet të zinje ti vendin e tij! Por ATË e vrau UDB-a, e ndihmuar nga tradhtarët shqipfolës..... dhe AI, në momentet e fundit të jetës së tij, i la amanet shoqes së tij të jetës, bashkëveprimtares së tij të ngushtë, që shokët të vazhdojnë rrugën e nisur,...që materialet e shtypit, numri i dytë i Zërit të Kosovës, i janarit, që ishte përgjakur me gjakun e të rënëve në veturën e Bardhoshit, të mos mbeten pa u shpërndarë...që fëmijët me m'i rritë e m'i bëj trima! Ai i përmendi disa herë shokët, shokët ore shokët...e atëhere kur ta paska lënë ty këtë "amanet"?!? Ti e akuzon Xhafer Durmishin, e akuzon shumë padrejtësisht.! Xhafer Durmishin, Jusufi nuk e morri për zëvendës, por për ta ndihmuar... Dhe ne, shokët, e kemi besuar dhe nderuar Xhaferin! Bardhoshi, më tha mua për Xhaferin se, ky është shoku ynë, është shok i mirë, i radhëve tona!…Por kurrë nuk më tha se, ky apo ti (Nuhiu) jeni zëvendës.!?" (ASKUSH S'MUND TA ZËVENDËSONTE DHE AS MUND TA ZËVENDËSOJË JUSUF GËRVALLËN!, www.albaniapress.com, 30 shtator 2010)

7-4. LËVIZJA U SHUA NJË MUAJ PAS VRASJES SË JUSUF GËRVALLËS

Ramadan Pllana: "AKTIVITETI I LNÇKVSHJ'së U SHUA NJË MUAJ PAS ATENTATIT MAKABËR QË U BË NË SHTUTGART MË 17 JANAR 1982

(Me shkas ndaj shkrimit të Xhafer Durmishit «Fakte rreth Lëvizjes së Jusuf Gërvallës», publikuar në «Pashtriku.org» janar 2011)

Të dashur miq e lexues të nderuar,

në vazhdim do të shihni se si e shuan Sabri Novosella, Xhafer Durmishi e kompani, me bekimin e Bujar Hoxhës, LNÇKVSHJ-në e lavdishme,të cilën e themeloi i madhi Metush Krasniqi, heroi ynë kombëtar, e të cilën e ndërtoi Jusuf Gërvalla, heroi ynë kombëtar. Tani, në shkrimet e tyre, këta „dëshmohen" si „shpëtimtarë" të LNÇKVSHJ-së dhe si „trashëgimtarë" të Jusuf Gërvallës...

... Në faqet 375-358 kemi dëshminë se si u bë Xhafer Durmishi "trashëgimtar" i Jusuf Gërvallës, me direktiva të Sabri Novosellës, në letrën dërguar Komitetit të degës së LRSHJ "Hasan Prishtina"në Stamboll, pra nuk thirret më dega e LNÇKVSHJ-së, shkruar më 26 shkurt 1982:

Letër drejtuar Komitetit të degës së LRSHJ "Hasan Prishtina"

Të dashur shokë!

Udhëtimin e Shpendit e quajtëm si shumë të suksesshëm. Ardhja e Halimit është me vend dhe angazhimi i tij i menjëhershëm me siguri do të jetë i frytshëm.

Ditën kur u kthye Shpendi pra të hënën ditën e parë të javës kur shokët ia filluan javës së re të punës. Meqë këndej shokët janë të shpërndarë në pika të ndryshme dhe që në atë javë nuk kishim farë automjeti mbledhja zgjedhore e Komitetit nuk mundi me u thirrë deri më 26.02.1982. atë mbrëmje në një qytet larg nga këtu u mblodhën:

Shpendi, Halimi, Drita, Agimi, Agroni, Arsimi, Halimi, dhe Guximi.

Mbledhjen e hapi Shpendi i cili në fillim i njoftoi të pranishmit mbi bashkimin, me organizatën e re dhe me detyrën dhe qëllimin e ardhjes së Halimit.

Ai për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite :

Formimi i Degës së « LRSHJ për Evropën Perëndimore.

a). Që kjo degë e LRSHJ ta merr emrin e dëshmorëve Gërvalla, pra të quhet komiteti « Vëllezërit Gërvalla »

b). Që Komiteti të përbëhet nga pesë anëtarë.

Të ndryshme

Ky rend dite u aprovua njëzëri nga të pranishmit.

1. Që në fillim u propozua të zgjidhen anëtarët e Komitetit pra pesë veta. Me që Agimi ishte edhe më parë përpara si arkëtar, Agroni si anëtarë së bashku me Dritën dhe me shpendin nuk u diskutua shumë rreth tyre të jenë anëtarë të Komitetit të riorganizuar apo jo. Halimi propozoi që komiteti t'i ketë edhe dy kandidatë ky propozim u quajt me vend dhe i arsyeshëm dhe si i tillë u aprovua. Arsimi që në fillim tha se pyetjen për arkëtarë nuk ka nevojë ta përsërisim pasi arkëtarin e vyeshëm e kemi nga fillimi, u miratua propozimi i Arsimit që edhe në Komitetin e ri për arkëtar të jetë agimi.

Shpendi pasi i numëroi disa detyra të cilat i ka pasur Drita si shoqe më e ngushtë e Sokolit (për të cilat disa nga të pranishmit nuk kanë qenë në dijeni), e njëherit i njoftoi se ajo pas një kohe do të shkoi në A. Ai atë e propozoi si sekretare deri sa ajo të jetë në mesin tonë. Ky propozim u aprovua unanimisht. Fjalën pastaj e morri Drita e cila u

falënderua dhe në vazhdim i njoftoi të pranishmit se Shpendi ishte njeriu që ishte udhëzuar ta ndihmonte Sokolin dhe për këto detyra të kryera ai kohët e fundit ishte pranuar edhe si anëtar i K.Q. të LNÇKVSHJ. Duke pas parasysh këtë, vazhdoi ajo, unë mendoj se ai duhet të jetë kryetar i komitetit të degës së LRSHJ për Evropën Perëndimore edhe me këtë propozim të pranishmit u pajtuan për anëtar mbetën Halimi dhe Agroni.

Me shkuarjen e Dritës ne do të mblidhemi prapë dhe në vendin e sekretarit do të zgjidhet Halimi (nënviz. i Shp.) ndërsa anëtar i ri i komitetit do të jetë arsimi. Kandidati i ri besojmë se në bazë të punës së tij do të pranohet Luli.

a). Propozimi që komiteti të quhet „Vëllezërit Gërvalla“ u pranua njëzëri.

Shpendi vazhdoi se është i mendimit që komiteti i degës së LRSHJ për Zvicër ta merr emrin e Kadri Zekës.

b). Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke pasur parasysh faktin se ishte i pranishëm anëtari për këtë mes Halimi edhe ca anëtarë tjerë të LNÇKVSHJ nuk dinin shumë lidhur me përbërjen në numër të një komiteti mbretëroi pak heshtja. Me këtë Shpendi shpjegoi se Lëvizja NÇ me këtë praktikë punon qe disa vite dhe se kjo formë është treguar mjaftë e suksesshme. Halimi vazhdoi se ai me shokët e tij kanë vepruar ndryshe dhe se nuk kanë shumë eksperiencë lidhur me funksionimin e një komiteti po dinë tetë veta. Ai tha se këta aktivistë të dalluar të jenë si kandidatë për komitet. Ky propozim dhe arsyetimi se ceka edhe më lart u pranua. Pra komiteti i degës së LRSHJ „Vëllezërit Gërvalla“ për Evropën perëndimore ka këtë përbërje:

Me shkuarjen e Dri. Mendoj se do të dukej kësi soji:

1. Shpendi Kryetar - (Xh. Durmishi)
2. Drita Sekretar Halimi - (Syzana Gërvalla)
3. Agimi Arkatar - (Faridin Tafallari)
4. Halimi Antar - (Arsimi nënviz. i Shp.) (Nuhi Sylejmani)
5. Agroni Antar - (Osman Osmani)
6. Halili Kandidat - (Hafiz Gagica)
7. Guximi Kandidat - (Haxhi Berisha)
8. Arsimi Përgjegjës i rinisë - (Naim Haradinaj)

2). Të ndryshme diskutimet u zhvilluan rreth anëtarësisë, ca probleme materiale vendosjes në bazën e re të nxjerrjes sa më shpejtë të numrit të ri të organit.

Për këto dhe të tjera herën e ardhme.

Ju përshëndesim shokët e kom. « Vëllezërit Gërvalla »

KOSOVA - REPUBLIKË" (Ramadan Pllana, AKTIVITETI I LNÇKVSHJ’së U SHUA NJË MUAJ PAS ATENTATIT MAKABËR QË U BË NË SHTUTGART MË 17 JANAR 1982, www.pashtriku.org, 15 shkurt 2011)

7-8. KY BASHKIM KISHTE DHËNË KONTRIBUT TË JASHTËZAKONSHËM

Ramadan Pllana: *"Në Turqi, zyrtarisht, ishte formuar Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSSHJ), një muaj pas vrasjes makabër të Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës, nga përfaqësues të dy grupimeve patriotike të fshehta, Sabri Novosella dhe Abdullah Prapashtica (të arratisur politik nga Kosova), kur me ndërmjetësimin e ambasadorit të Shqipërisë në Turqi, Bujar Hoxha shpallin bashkimin e organizatave ilegale. LRSSHJ ishte vazhdimësi e organizatave, LNÇKVSHJ, OMLK, FKP dhe i PKMLSHJ.* ***Ky bashkim kishte dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në luftën për të drejtat e barabarta të shqiptarëve me popujt tjerë në ish-Jugosllavi, për krijimin e Republikës së Kosovës bashkë me të drejtën për***

shkëputje në rast të shpërbërjes së RSFJ-së." (Xhavit Haziri - një hero i merituar, www.albaniapress.com, 1 shtator 2011)

7-9. PAS VRASJES SË TYRE KA NDODHUR AJO QË KA NDODHË PAS VRASJES SË ADEM JASHARIT

"Xhafer Shatri: Unë kur kam dalë në Itali së pari jam përpjekur me hy në Zvicër dy herë nuk kam arritur dhe pastaj më kanë quar poshtë në Itali dhe përmes njerëzve atje e kam parë që ka filluar aktiviteti politik i mërgatës tonë jashtë, por dua të them se derisa isha në burg me trishtim të thellë kam lexuar për vrasjen e Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës. Natyrisht ka qenë një lajm krejt i vogël në Rilindje dhe në Radio Prishtinë. Edhe kur kam dalur jashtë pastaj nga Italia kam shkuar në Zvicër e e kam parë efektin e aktivitetit të tyre dhe efektin konkret të vrasjes së tyre.

Agron Bajrami: Cili ishte?

Xhafer Shatri: Ai ishte një efekt i dyfishtë. Ishte një dhimbje që është vështirë ta përshkruaj sot sepse ata ishin njerëz që mërgata e re shqiptare e Kosovës identifikohej përmes tyre. Ata ndiheshin si fëmijët jetimë. E para. E dyta shihej aktiviteti i tyre sepse ata njerëz anise shumica dërmuese e tyre ishin punëtor të thjeshtë ishin ngjallur dhe debatonin për problemet ë ndryshme politike dhe kishin një vendosmëri të jashtëzakonshme për t'iu shkuar gjërave deri në fund për çlirimin e Kosovës. Edhe në anën tjetër në rrafshin organizativ kur thuhej se çka do të bëhej tash shihej pikërisht këtu shihej mungesa e madhe e Jusufit, e Kadriut e Bardhoshit për të cilët, një ekip i një lëvizje kombëtare i duhen vite të tëra për ta pasur, për arsyen e thjeshtë se, ta zëmë Jusuf Gërvalla ishte një person publik, ishte një gazetar, ishte një poet, ndër më të mirët e gjeneratës së vet, ishte këngëtar, ishte publicist i mirë, që është aq e domosdoshme për një lëvizje ilegale të ketë njerëz që ta nxjerrin gazetën ashtu siç duhej të ishte. Në anën tjetër ishte Kadri Zeka, njeri që në dhjetë vite kishte vepruar në radhët e organizuara, i kishte takuar një organizate ilegale këtu, gazetar me profesion, njeri që e njihte Kosovën cep më cep, njeri jashtëzakonisht i përgatitur për t'i organizuar njerëzit. Në anën tjetër ishte Bardhosh Gërvalla për të cilin flitet pak dhe i hyhet mendoj shumë në hak nga njerëzit tanë. Ai ishte një njeri i cili i fliste dy gjuhë në mënyrë të shkëlqyer, anglishten dhe gjermanishten. Do të thotë për një lëvizje kombëtare një tresh i tillë që personifikonte nxjerrjen e gazetës, emrin e mirë, një organizator, tjetër, dhe një njeri i cili ishte i përgatitur për të komunikuar me botën në gjuhët e tyre, do me thënë është një tresh që vetëm njerëzit që janë marrë me këtë punë humbjen e tyre mund ta shpjegojnë në dimenzionin e sajt ë vërtetë.

Agron Bajrami: Si ju kuptoj, thuani se, nuk u arritur kurrë pas vrasjes së tyre lëvizja ilegale t'i zavendësoj ata të them ashtu kushtimisht në plotësimin e këtyre detyrave të them ashtu nuk ka pasur pas tyre njerëz që kanë mund ta marrin më tutje udhëheqësinë në atë mënyrë sikur ata!?

Xhafer Shatri: Shiqoni, pas vrasjes së tyre ka ndodhur ajo që ka ndodhë pas vrasjes së Adem Jasharit, me familjen e tij dhe me njerëzit e tij. Autoritetet jugosllave atëherë kanë menduar se vërtetë lëvizjen ilegale e shpartalluan përgjithmonë. Por ndodhi krejtësisht e kundërta sepse ata kishin lënë shokë, ata kishin lënë njerëz, ata kishin lënë një bazë të mirë që njerëzit kudo që ishte, vetëm a e kishte vullnetin e mirë, a e kishte minimumin e aftësisë që mund ta vazhdonte punën dhe për habinë e atyre që i kishin vra ata, demonstratat të cilat ata i kishin filluar me 300-400 njerëz , vrasja e tyre aq shumë i idhnoi njerëzit, aq shumë i mobilizoi njerëzit pastaj sa nuk flitej më për qindra demonstrues por për mijëra demonstrues, pastaj edhe qëndresa në Kosovë dhe shtypja që i bëhej Kosovës ishte një motiv i madh brenda dhe jashtë për t'iu kundërvënë

pushtuesve me të gjitha mjetet e mundshme, dhe ne arritëm pak a shumë ta plotësojmë atë boshllëk, por ai ishte boshllëk kaq i madh sa që ishte shumë vështirë për ne ta kemi edhe në të ardhmen një treshe të tillë." (Intervistë dhënë Agron Bajramit, www.koha.net, 27 korrik 2012, Press-ing, program televiziv, minutat 20-24)

7-10. SI TRIM I MIRË ME SHOKË SHUMË

Kadri Rexha: *"Edhe qëllimi i tretë do të dështojë. Dhe, këtu nuk kam asnjë fije dyshimi. Sikur Skënderbeu, edhe Jusuf Gërvalla, për jetë të jetëve do t'i çajë shekujt e historisë, si trim i mirë me shokë shumë."* (Mendjelehtësi apo diçka tjetër, lidhur me artikullin „Katër rrëfime për Jusuf Gërvallën", të nënshkruara nga Fokusipress, botuar në gazetën „Fokusi", nr. 10, datë 17 janar 2004, faqe 3-7)

8. LUFTA PËR FRON DHE FATI I FRONTEVE

Një luftë për fron motivohet nga dy apo më shumë pretendues të fronit, pas një monarku të vdekur apo të rrëzuar. Individët përkrahen nga fraksionet brenda oborrit mbretëror, e gjithashtu forca të jashtme mund të ndërhyjnë duke lidhur aleanca me ndonjë fraksion.

8-1. Lufta e Madhe Civile Abaside
8-2. Anarkia (The Anarchy)
8-3. Lufta për Fronin e Champagne
8-4. Lufta për Fronin e Flanders dhe Hainault
8-5. LUFTA PËR FRONIN E THURINGUT
8-6. Lufta për Fronin Bizantin 1341-1347
8-7. Lufta për Fronin e Guelders
8-8. Kriza Portugeze e viteve 1383-1385
8-9. Lufta për Fronin e Breton-it
8-10. Lufta për Fronin e Lituanisë (1431-1435)
8-11. Lufta për Fronin e Stettin-it
8-12. Lufta për Fronin e Kastiljës
8-13. Lufta për Fronin e Landshut
8-14. Lufta për Fronin e Inkas
8-15. Lufta për Fronin e Portugalisë
8-16. Lufta për Fronin e Polonisë (1587-88)
8-17. Lufta për Fronin e Jülich-ut
8-18. Lufta për Fronin Mantuan
8-19. Lufta për Fronin e Pfalzit (Der Pfälzische Erbfolgekrieg (1688–1697)
8-20. Lufta për Fronin e Spanjës
8-21. Lufta për Fronin e Polonisë (1733-1738)
8-22. Lufta për Fronin e Austrisë
8-23. Lufta për Fronin e Bayernit
8-24. Lufta rreth Fronit Miguelite

8-1. LUFTA E MADHE CIVILE ABASIDE

Lufta e Madhe Civile e Abasidëve ka qenë një konflikt në mes vëllezërve al-Amin dhe al-Ma'mun rreth fronit të kalifatit të Abasidëve. Babai i tyre, Harun al-Rashid, e kishte emruar al-Aminin si trashëgimtarë (pasues) të parë, por e kishte emruar edhe al-Ma'mun, si trashëgimtarë të dytë duke ia dhuruar atij Khurasan-in si *appanage*, në ndërkohë që djalin e tretë, al-Qasim e kishte përcaktuar si trashëgimtarë të tretë.

Pas vdekjes së Harun në vitin 809, në fronin e tij në Bagdad u vendos al-Amini. I nxitur nga oborrtarët e tij në Bagdad, al-Amini filloi ta shembë pozitën autonome të Khurasan-it; Qasim mjaft shpejt gjendet në pozitë jashtë loje. Në përgjigje të kësaj, al-Ma'mun kërkon mbështjetjen e elitave proviniciale të Khorasan-it, dhe merr masa për ta mbrojtur pamvarësinë e tij.

Në kohën kur hendeku në mes dy vëllezërve dhe përkrahësve të tyre vjen duke u thelluar, al-Amini e shpallë djalin e tij Musën si trashëgimtar të tij, dhe e mbledhë një armatë të madhe. Trupat e al-Aminit marshojnë drejt Khurasan-it, por gjenerali i al-Mamunit, Tahir ibn Husayn i mund ato në Luftën e Rayy, dhe më pas e invadon Irakun dhe e rrethon vetë Bagdadin. Qyteti bien pas një viti, al-Amini ekzekutohet, dhe al-Ma'mun bëhet Kalif, por ai qëndron në Khurasan dhe nuk shkon në Bagdad.

Kjo rrethanë ndikon që ai vakum-pushteti që lufta civile e kishte krijuar në provincat e Kalifatit, të rritet edhe më tej, dhe të sjellë paraqitjen në skenë të shumë sundimtarëve lokal në Jazira, Siri dhe Egjipt. Pos kësaj, ajo politikë pro-Khurasani e ndjekur nga kryeministri i fuqishëm i al-Mamunit, al-Fadl ibn Sahl, dhe përkrahja për një Alid trashëgimi, i armiqëson elitat tradicionale të Bagdadit, të cilat e shohin veten gjithnjë e më të margjinalizuara. Si pasojë e kësaj, axha (vëllau i babait apo Baca) i al-Ma'munit, Ibrahimi, më 817 shpallet Kalif në Bagdad, duke e detyruar kështu al-Mamunin të ndërhyj personalisht. Fadl ibn Sahl vritet dhe al-Mamun e len Khorasanin dhe shkon në Bagdad, në të cilin hyn më 819. Vitet vijuese kalojnë në shenjë të konsolidimit të autoritetit të al-Mamunit dhe integrimin e provincave perëndimore, proces i cili arrin të kompletohet tek në vitin 827. Disa kryengritje lokale kanë vazhduar për një kohë edhe më të gjatë.

Ky konflikt, kjo luftë civile është interpretuar në mënyra të ndryshme. Sipas iranologut Elton L. Daniel, ky ka qenë "një konflikt për fron në mes budallait inkompetent al-Amin dhe vëllaut të tij dinak dhe kompetent al-Ma'mun, si produkt i intrigave të haremit; dhe në zgjerim, si rivalitet personal në mes ministrave al-Fadl ibn Rabi dhe al-Fadl ibn Sahl, ... apo edhe si një luftë në mes arabëve dhe persianëve për ta kontrolluar qeverinë."

Vrasja e tyre kishte këtë qëllim të mbrapshtë

Hasan Mala: *- Me sa di unë dhe nuk besoj se gabohem, u arrit vetëm në ditët e fundit të jetës së Kadri Zekës dhe Jusuf e Bardhosh Gërvallës. Ata u takuan disa herë në qytete të ndryshme të Gjermanisë, - më në fund në Shtutgart - dhe, më në fund, u morën vesh jo vetëm që të dyja organizatat të shkriheshin në një, por kështu të bëhej edhe me të dyja organet që botonin ato, përkatësisht 'Liria' dhe 'Zëri i Kosovës'. Të kishte pra vetëm një gazetë, dhe ajo të quhej* ***'Liria'****. Dhe Taip Zeka ka të drejtë kur mendon se ata qëndruan edhe një natë së bashku, për t'iu gëzuar në njëfarë mënyre, këtij bashkimi të shumëpritur. Dhe vrasja e tyre kishte pikërisht edhe këtë qëllim të mbrapshtë, të pengonte me çdo kusht dhe me çdo mjet bashkimin e organizatave dhe krijimin e* ***Frontit****, gjë që ndodhi realisht."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009, faqe 256-257)

8-2. ANARKIA (THE ANARCHY)

Anarkia (The Anarchy) ka qenë një luftë civile në Angli dhe Normandi në mes viteve 1135-1153 e karakterizuar nga një shembje e ligjit dhe rendit. Burimi i konfliktit ka qenë një rend krizash kah fundi i kohës së qeverisjes së Henry I, në kohën kur djali i vetëm legjitim i mbretit, Wiliam Adelin ka vdekur në anijen White Ship. Përpjekjet e Henry për ta instaluar bijën e tij, Perandoreshën Matilda, si pasuese (trashëgimtare) të tij kanë qenë të pasuksesshme dhe me rastin e vdekjes së Henry më 1136, nipi i tij Stephen of Blois e merr pushtetin me ndihmën vëllaut të tij, Henry of Winchester. Koha e hershme e qeverisjes së Stefanit është karakterizuar nga luftime të ashpra në mes baronëve anglezë, udhëheqësve të Velsit dhe invaduesve skocez. Pas një kryengritje të madhe në jug-perëndim të Anglisë, më 1139 Matilda bënë një invadim me ndihmën e gjysmë-vëllaut të saj, Robert of Gloucester.

Asnjëra palë nuk ka qenë në gjendje të arrijë një përparësi vendimtare gjatë viteve të para të luftës; Perandoresha arrin të kontrolloj Anglinë Jugperëndimore si dhe pjesë të mëdha të Luginës së Temzës (Thames Valley), ndërsa Stephen e ka kontrolluar pjesën juglindore.

Kështjellat e asaj kohe ka qenë lehtë të mbrohen, dhe shumë prej luftimeve kanë pasur karakter të tretjes e harxhimit të forcave, duke përfshi këtu rrethime të gjata kohore, plaçkitje, duele të shkurta të armatave të kalorësve dhe këmbësorëve, shumë prej tyre mercenarë. Në vitin 1141 Stephen zihet rob në luftën e Lincoln-it, gjë që shkakton shembjen e autoritetit të tij në pjesën më të madhe të vendit.

Perandoresha Matilda ka qenë e detyruar të tërhiqet nga Londra nga masat popullore armiqësore, para se ajo të arrij të kurorëzohet si mbretëreshë; pak më vonë, Robert zihet rob në rrugën e Winchesterit dhe të dy palët pajtohen që të bëjnë këmbimin e robërve. Stephen gati sa e zen rob Matildën më 1142 gjatë rrethimit të Oksfordit, por Perandoresha arrinë të ik prej Kështjellës së Oksfordit duke e kaluar lumin e ngrirë të Temzës dhe të shkoj në vend të sigurt.

Lufta zgjati për shumë vite. Burri i Matildës, Geoffrey of Anjou në mënyrë të suksesshme e pushtoi Normandin, por në Angli asnjëra palë nuk arrinë të sigurojë fitore. Baronët rebelues fillojnë të fitojnë pushtet gjithnjë e më të madh në Anglinë Veriore dhe Lindore, duke përfshi kështu edhe një shkatërrim të madh të regjioneve të përfshira në luftime. Më 1148 Perandoresha kthehet në Normandy, dhe fushatën e saj në Angli e lenë në duart e djalit të saj të vogël, Henry Fitzempress. Stephen, nuk ka sukses të ndikoj tek kisha, në mënyrë që ajo ta njeh djalin e tij si mbretin e ardhshëm të Anglisë. Në fillim të viteve 1150, si baronët ashtu edhe kisha e dëshirojnë një paqe afatgjate.

Kur Henry e invadon përsëri Anglinë më 1153, forcat e të asnjërit fraksion nuk kanë vullnet të luftojnë. Pas fushatash të kufizuara dhe rrethimit të Wallingfrodit, Stephen dhe Henry janë pajtuar për një marrëveshje paqeje, Marrëveshja e Winchesterit, përmes të cilës Stephen e njeh Henry si trashëgimtar të tij.

Stephen vdes në vitin vijues dhe Henry II e fillon atë periudhë të gjatë të rindërtimit në Angli. Kronikanët e kanë përshkrua periudhën si kohë në të cilën ”Krishti dhe shenjtorët e tij kanë qenë në gjumë, dhe historianët Viktorian e kanë quajtur konfliktin ”Anarkia” për shkak të kaosit, edhe pse historianët modern i kanë vënë pikëpyetje termit në fjalë.

Pozita inferiore e Frontit të Kuq
të bashkëformuar dhe emërtuar nga UDB-a

Shkolla e UDB-së: "*Në këtë pozitë inferiore nga ana e „zëvendësit“, ndjehej edhe udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 89)

8-3. LUFTA PËR FRONIN E CHAMPAGNE

Lufta për Fronin e Champagne ka qenë një luftë në vitet 1216-1222 në mes aristokracisë në regjionin Champagne të Francës, e cila fillon në atë regjion dhe shkapërderdhet në principatat përreth. Lufta ka zgjatë dy vjet dhe faktikisht ka përfundua më 1218, por zyrtarisht nuk ka marrë fund përderisa Theobaldi IV e ka arritur moshën madhore (pjekurisë) në vitin 1222, kur rivalët e tij i kanë tërhequr kërkesat e aspiratat e tyre.

8-4. LUFTA PËR FRONIN E FLANDERS DHE HAINAULT

Lufta për Fronin e Flanders dhe Hainault ka qenë një seri konfliktesh në mesin e shekullit të trembëdhjetë në mes fëmijëve të Margaretës II, Konteshë e Flanders. Ato kanë pasur të bëjnë me trashëgiminë e dy qarqeve, i pari çiflig prej mbretit të Francës dhe i dyti nga mbreti i Gjermanisë.

Kur Baldwin IX, Konti i Flanders dhe Hainault, niset në Kryqëzatën e Katërt më 1202, ai i len domenet e tij perëndimore nën bijën e tij të madhe Joanna. Me rastin e vdekjes së Baldwinit, Joanna i trashëgon qarqet, por përkundër dy martesave ajo vdes pa trashëgimtar në vitin 1244. Ajo pasohet nga motra e saj më e re, e lartpërmendura Margareta.

Martesa e parë e Margaretës me Bouchard of Avesnes, prishet gjatë vitit 1221 me urdhër të Joannës dhe shkishërimit të Bouchardit. Me Bouchardin, ajo i ka pas veç tre fëmijë, në mesin e tyre John I of Avenses. Prapë se prapë, Margareta e rimartuar më 1223, me Vilhelm II of Dampierre (i vdekur më 1231), i la tre pasardhës, në mesin e tyre Wiliam III dhe Guy of Dampierre.

Kërkimi i së drejtës së trashëgimisë së Margaretës në mes bijve of Avesnes dhe atyre of Dampierre ka qenë shkaku i atyre konflikteve që janë të njohur si ”lufta për trashëgiminë e Flanders dhe Hainault.”

Pozita inferiore e Shkollës së UDB-së Serbe

Muharrem Blakaj: "*Virtytet e një burri të **papërkulshëm** siç ishte Nuhi Sylejmani, u hetuan me kohë nga Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi, prandaj nuk ishte e rastit që vendimet më kapitale që u morën në atë kohë të jenë **në bashkëpunim të barabartë me të, ...** Nuhi Sylejmani, autori i këtij libri, duke shpalosë kujtimet e tij të veneruara nga një këndvështrim tjetër, **të përjetuara nga një inferioritet vandal**,..."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 7- 8)

8-5. LUFTA PËR FRONIN E THURINGUT

Lufta për Fronin e Thuringut (gjermanisht: thüringisch-hessische Erbfolgekrieg), (1247-1264) ka qenë një konflikt ushtarak mbi një pasardhës të Kontit të fundit të Thüringen në Gjermaninë e sotme. Me vdekjen e Kontit Raspe më 1247, i cili nuk

kishte fëmijë, vija mashkullore Ludowinngiane e kontëve të Thüringut shuhet. Në pasurinë e tij nuk kanë hy vetëm pjesë të mëdha të Thüringut, por edhe qarku i Hessenit ishte futur në posedimin Ludowingian përmes vijës femërore. Në vitin 1122, para se ai ta fitoj titullin Kont (Landgrave), Konti Louis I i Thüringut, ishte martuar me Hedwig of Gudensberg, trashëgimtaren femrore të qarkut të Hesenit, familjen Gisonen. Familja Gisonen, tokat e së cilës fillimisht kanë qenë kryesisht në pjesën e epërme të rrethinës së Lahn-it, më heret kishin marrë toke, përmes një trashëgimi të rëndësishëm nga Konti Werner, edhe në Hesenin e poshtëm. Pastaj, përmes martesës, Giso së IV me Kunigunde of Bilstein, gjithashtu ata kishin fituar një pasuri të gjerë dhe të drejtën e kujdestarisë nga kontët of Bilstein.

Kërkesat në trashëgiminë Ludowingiane u bënë nga (mbesa) bija e motrës së Henry Raspes dhe nga (nipi) djali i motrës. Sophie of Thuringia, e martuar me Henrik II, Duke of Barbant dhe Lothier, ka qenë e bija e vëllaut të Henry Raspes, Louis IV dhe ajo ka bërë kërkesë për territoret për llogari të djalit të saj Henry.

(Motra e Sophie-s, Gertrude, ka qenë murgeshë në manastirin perandorak Altenberg në Wetzlar, dhe në këtë mënyrë e përjashtuar nga trashëgimia.) Henry III, (Margrave of Meissen), ka qenë djali i motrës së Herny Raspes, Jutta. Një konkurrent tjetër ka qenë arqipeshkvi i Mainz-it, i cili kërkesat e tij i ka mbështetur në atë se Hesseni ka qenë çiflig i kishës, dhe pas shuarjes së Ludowingianëve, kërkonte kthimin e tij.

Nuk më ngeli gjë tjetër veçse t'i përfillja urdhrat e zonjës së shtëpisë

Shkolla e UDB-së: "***Edhe pas propozimit tim që të formohej një organizatë e ngjashme*** *politike e mos të bëheshin përpjekje për ta zëvendësuar atë që ishte e pamundur, nuk më ngeli gjë tjetër veçse t'i përfillja urdhrat e zonjës së shtëpisë...*" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Përsihtinë 2010, faqe 88)

8-6. LUFTA PËR FRONIN BIZANTIN 1341-1347

Lufta civile Bizantine e viteve 1341-1347, nganjëherë quhet edhe Lufta e Dytë Civile Palailogane, ka qenë një konflikt që ka shpërthye pas vdekjes së Andronikos III Palaiologos, gjatë kujdestarisë së djalit dhe trashëgimtarit të tij nëntë vjeçarë, John V Palaiologos. Lufta e polarizoi shoqërinë bizantine përgjatë kufijve klasor, me Kantakouzenos i përkrahur nga aristokracia dhe shtresave të ulëta dhe të mesme të cilat përkrahin qeverinë e trashëgimtarit ende të mitur. Në një masë më të vogël konfliktit i janë dhënë edhe dimensione religjioze. Bizanti ka qenë i përfshirë në kontradiktën Hesychast-it, dhe bashkangjitja në këtë doktrinë mistike të Hesykastit është konsideruar si përkrahje për Kantakouzenos.

Si ndihmësi më i afërm i Perandorit Andronikos III, Kantakouzenos udhëheqë mbretërinë gjatë kohës së të miturit John V, kur Perandori vdes në korrik 1341. Gjatë kohës kur Kantakouzenos është jashtë Konstantinopojës, në shtator të të njejtit vit, Alexios Apokaukos dhe patriarku John XIV duke e siguruar mbështetjen e Perandoreshës Ana e formojnë një qeverie kujdestarie. Në përgjigje të kësaj, armata e Kantakouzenos dhe përkrahësit e proklamojnë bashkë-perandor në tetor, duke e ngurtësuar hendekun në mes tij dhe qeverisë së re. Ndarja shkallëzohet menjëherë në një konflikt të armatosur.

Gjatë viteve të para të luftës, forcat e mbretërisë së re korrin fitore. Në vazhdën e shumë kryengritjeve antiaristokrate, sidomos prej Zealotëve në Selanik, pjesa më e madhe e qyteteve në Thraki dhe Maqedoni bien bien nën kontrollin e mbretërisë. Me ndihmën e Stefan Dushanit të Serbisë dhe Umur Begut të Aydinit, Kantaouznos me

sukses i neutralizon fitoret e kundështarëve. Në vitin 1345, përkundër kalimit të Dushanit në anën e opozitës dhe tërheqjes së mbështetjes prej Umur-it, Kantaouznos e mban epërsinë falë ndihmës së Orhanit, sunduesit të emiratit otoman. Gjatë qershorit 1345 vrasja e administratorit më të lartë të regjencës megas doux Apokaukos, ishte një goditje e rëndë për regjencën. Formalisht i kurorëzuar si perandor në Adrianopojë më 1346 Kantakouzenos hyn në Konstantinopojë më 3 shkurt 1347. Përmes marrëveshjes ai qeverisë si perandor senior dhe regjentë për John V, përderisa djali e arrinë moshën madhore dhe qeverisi së bashku me te.

Përkundër kësaj fitoreje të dukshme, John VI detyrohet ta rivazhdoj luftën civile dhe ta dhe ta detyroj Kantakouzenos, në vitin 1354, të abdikoj, të shkoj në pension dhe të bëhet murg.

Pasojat e këtij konflikti të gjatë tregohen si katastrofale për perendorinë, e cila e kishte fituar një shkallë të stabilitetit gjatë kohës së Andronikut III. Shtatë vjet luftë, prezenca e armatave plaçkitëse, kaosi social dhe Murtaja e zezë e shkretojnë Bizantin. Konflikti i jep mundësi Dushanit ta pushtojë Shqipërinë, Epirin dhe pjesën më të madhe të Maqedonisë dhe në ato pjesë ta kurdisë Perandorinë e Serbisë. Perandoria bullgare fiton territore gjithashtu në veri të lumit Evros.

Kurrë nuk e mora vesh pse Lëvizja e Jusuf Gërvallës dhe Zëri i Jusuf Gërvallës i përballuan në mënyrën më të fuqishme atentatit kundër Jusuf Gërvallës më 17 janar 1982:

-A ishte kjo meritë e inferioritetit të Frontit Popullor?!

-A ishte kjo meritë e inferioritetit të Frontit të Kuq të UDB-së?! apo

-A ishte kjo meritë e inferioritetit të Partisë "Komuniste" të Shkollës së UDB-së Serbe?!

8-7. LUFTA PËR FRONIN E GUELDERS

Lufta për Fronin e Guelders ka qenë një luftë për qarkun Guelders që ka zgjatë në mes viteve 1371 dhe 1379.

Lufta filloi kur Duka Rainald III vdes në vitin 1371 pa trashëgimtar. Vëllau i tij Eduardi, i cili ishte vrarë në Luftën e Baesveiler gjithashtu nuk kishte lënë trashëgimtarë. Pretenduesit e Fronit të Dukës kanë qenë dy bija të Dukës Rainald II: Matilda, e cila ka qenë e martuar me John II, Konti nga Blois, dhe Maria, gruaja e Viliamit II nga Jülich dhe nëna e Viliamit I nga Guelders dhe Jülich, për llogarinë e të cilit ajo e ka kërkuar Fronin e Guelders.

Gjatë shekullit XIV Gulederѕ ndahet në dy fraksione. Heeckerenët e përkrahin Matildën dhe Bronkorstenët e përkrahin Viliamin. Lufta ka zgjatë tetë vjet, ku Maria dhe përkrahësit e saj dalin fitimtarë dhe i biri i Marijës Viliami bëhet Dukë i Guelders.

8-8. KRIZA PORTUGEZE E VITEVE 1383-1385

Kriza e viteve 1383-1385 ose "Interregnumi Portugez" ka qenë kohë e luftës civile në historinë e Portugalisë, kur nuk ka mbretëruar asnjë mbret i kurorëzuar. Ajo fillon kur mbreti Ferdinand I i Portugalisë, vdes pa lënë ndonjë trashëgimtarë nga linja mashkullore, dhe përfundon kur mbreti John I kurorëzohet në vitin 1385 pas Betejës së Aljubarrota. Portugezët e interpretojnë këtë epokë si rezistencën e tyre më të hershme kombëtare kundër intervenimeve Kastiliane. Robert Durant e konsideron atë si "ngritjen

e madhe të vetëdijes kombëtare". Burgesses dhe fisnikët veprojnë së bashku për vendosjen e dinastisë Aviz (një degë portugeze e familjes Burgundy = House of Burgundy), për të siguruar një Fron mbretëror të pavarur, për ndryshim nga lufta e gjatë civile, që në Francë quhet Lufta Njëqindvjeçare dhe në Angli Lufta e Rozave (War of the Roses), ku fraksionet aristokrate luftojnë fuqishëm kundër një monarkie të centralizuar.

Vrasja e tyre kishte këtë qëllim të mbrapshtë

Hasan Mala: *- Me sa di unë dhe nuk besoj se gabohem, u arrit vetëm në ditët e fundit të jetës së Kadri Zekës dhe Jusuf e Bardhosh Gërvallës. Ata u takuan disa herë në qytete të ndryshme të Gjermanisë, - më në fund në Shtutgart - dhe, më në fund, u morën vesh jo vetëm që të dyja organizatat të shkriheshin në një, por kështu të bëhej edhe me të dyja organet që botonin ato, përkatësisht 'Liria' dhe 'Zëri i Kosovës'. Të kishte pra vetëm një gazetë, dhe ajo të quhej* ***'Liria'****. Dhe Taip Zeka ka të drejtë kur mendon se ata qëndruan edhe një natë së bashku, për t'iu gëzuar në njëfarë mënyre, këtij bashkimi të shumëpritur. Dhe vrasja e tyre kishte pikërisht edhe këtë qëllim të mbrapshtë, të pengonte me çdo kusht dhe me çdo mjet bashkimin e organizatave dhe krijimin e* ***Frontit****, gjë që ndodhi realisht."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009, faqe 256-257)

8-9. LUFTA PËR FRONIN E BRETON-IT

Lufta për Fronin e Breton-it ka qenë një konflikt në mes familjeve "Hous of Blois" dhe Montfort për kontrollin e qarkut "Duchy of Brittany". Ajo është zhvilluar në mes viteve 1341 dhe 1364. Ajo ka qenë pjesë integrale e kohës së fillimeve të Luftës Njëqindvjeçare (Hundred Years War) për shkak të ndërhyrjeve të qeverisë Franceze dhe Angleze në konflikt; Francezët i kanë përkrahë Blois-ët ndërsa anglezët Montfort-ët. Edhe pse Montfortët patën sukses pas Betejës së Auray në vitin 1364, kanë qenë francezët ata që kanë pasë më së shumti dobi prej fitores së kësaj shtëpie.

8-10. LUFTA PËR FRONIN E LITUANISË (1431-1435)

Lufta Civile e Lituanisë (1431-1435), ka qenë një konflikt për fronin e qarkut të madh të Lituanisë (Grand Duchy of Lithuania), pas Vytautas-it të Madh, i cili ka vdekur më 1430 pa lënë ndonjë trashëgimtar. Lufta është zhvilluar në njërën anë nga Švitrigaila, në aleancë me Kalorësit gjerman (Teutonic Knights), dhe në anën tjetër nga Sigismund Kęstutaitis, i përkrahur nga Mbretëria e Polonisë. Lufta ka kërcënuar ta shkatërroj Unionin e Krevos (The Union of Krevo), unionin personal në mes Polonisë dhe Lituanisë. Aleanca e Švitrigailas me Mjeshtrin e Madh të Teutonikëve (Grand Master of the Teutonic Order) Paul von Rusdorf bëhet shkak për Luftën e Polonisë kundër Teutonikëve (1431-1435) por nuk ka sukses që t'ia siguroj fitoren Švitrigailas.

Kur Sigismundi e rrëmben pushtetin në Lituani përmes së inskenimit të një puçi më 1432, Lituania ndahet në dy taborre kundërshtare, dhe nga aty fillon një luftë trevjeçare me armiqësi rrënimtare. Për t'i parandaluar Kalorësit teutonikë që të vazhdojnë mbështetjen e tyre për Švitrigailan, Polonia e përkrahë një invadim të Husitëve kundër Prusisë më 1433. Lufta përfundon me një humbje përfundimtare për Švitrigailan dhe aleatët e tij, degën Livoniane të Kalorësve teutonikë, në Luftën e Pabaiskas në shtator 1435. Švitrigaila kapitullon përfundimisht më 1437. Sigismund Kęstutaitis e drejtoi Lituaninë vetëm për tetë vjetë para se ai të vritet më 1440.

Pozita inferiore e Frontit të Kuq
të bashkëformuar dhe emërtuar nga UDB-a

Shkolla e UDB-së: "*Në këtë pozitë inferiore nga ana e „zëvendësit“, ndjehej edhe udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 89)

8-11. LUFTA PËR FRONIN E STETTIN-IT

Lufta për Fronin e Stettinit ka qenë një konflikt në mes Kontëve të Pomeranisë dhe Kontit të Brandenburgut (Kurfürst von Brandenburg). Ajo ka filluar më 1464, pas vdekjes së Kontit Otto III, si Konti i fundit i Pomeranisë-Stettinit. Kontët e Pomeranisë-Wolgastit, Eric II dhe Vratisllavi X, e kanë konsideruar veten si trashëgimtarë legjitim të Ottos III. Konti Frederik II (Friedrich II, Kurfürst von Brandenburg) ka konsideruar se Pommern-Stettini ka qenë një çiflig i Brandenburgut. Pas vdekjes së Kontit të atij qarku, Otto III, pa lënë ndonjë trashëgimtar nga linja mashkullore, ai do të duhej t'i kthehej Brandenburgut.

8-12. LUFTA PËR FRONIN E KASTILJËS

Lufta për Fronin e Kastiljës ka qenë një konflikt në vitet 1475 dhe 1479 për Kurorën e Kastiljës, që është bërë në mes të përkrahësve të Joanna la Beltraneja, të bijës së monarkut Henry IV të Kastiljës, dhe atyre të gjysmëmotrës së Henryt, Isabelës, e cila ka qenë jashtëzakonisht e suksesshme.

Lufta ka pasur një karakter të qartë ndërkombëtar, pasi Isabela ka qenë e martuar me Ferdinandin, trashëgimtarin e Kurorës së Aragonisë, ndërsa Joanna, e këshilluar prej përkrahësve të saj, lidhë martesë strategjike me dajën e saj, Mbretin Alfonso V të Portugalisë. Franca intervenon duke e mbajtur anën e Portugalisë, pasi ajo ka qenë rivale e Aragonisë për territore në Itali dhe Rousillon.

Përkundër disa sukseseve fillestare të përkrahësve të Joannës, për shkak të mungesës së veprimeve sulmuese të Alfonsos V dhe pozitës pa fitues gjatë betejës në Toro më 1476, sjellin tek shkapërderdhja e aleancës së Joannës dhe njohjes së Isabellës në qarqet e Madrigal-Segovias (prill-tetor 1476).

Më pas përmbajtja e këtij konflikti ka qenë lufta në mes Kastiljës dhe Portugalisë. Lufta detare në Atlantik fiton peshë pasi flotat Portugeze i mundin ato Kastiliane në betejën për të pasur qasje detare në pasuritë e Guinesë (në ari dhe skllevër), ku edhe zhvillohet beteja vendimtare detare në Guine më 1478.

Lufta ka përfunduar më 1479 me nënshkrimin e Traktatit të Alcáçovas, përmes të cilit Isabela dhe Ferdinandi njihen si suveren të Kastiljës, Porugalisë i njihet e drejta e hegjemonisë në Atlantik me përjashtim të Ujdhesave Kanarie. Joanna e humbë të drejtën për fronin e Kastiljës dhe qëndron në Portugali deri në vdekjen e saj.

Ky konflikt nganjëherë është quajtur Lufta e Dytë Civile e Kastiljës, por ky emërtim mund të ngatërrohet me lufta tjera civile që kanë ndodhë në Kastiljë në shekujt XIV dhe XV. Disa autor e quajnë si Lufta e Portugalisë; por ky term nga pikëpamja Kastiliane nuk është i drejt sepse do t'a diskriminonte legjitimitetin e aleancës në të mirë të Joannës. Në raste tjera është përdorë termi Lufta e Gadishullit (Iberik), por këtu lehtë mund të bëhet ngatërrimi me Luftën e Gadishullit Iberik (1808-1814), si pjesë e luftërave të Napoleonit. Disa autor e preferojnë termin neutral Lufta e viteve 1475-1479.

Pozita inferiore e Shkollës së UDB-së Serbe

Muharrem Blakaj: "*Virtytet e një burri të **papërkulshëm** siç ishte Nuhi Sylejmani, u hetuan me kohë nga Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi, prandaj nuk ishte e rastit që vendimet më kapitale që u morën në atë kohë të jenë **në bashkëpunim të barabartë me të, ...** Nuhi Sylejmani, autori i këtij libri, duke shpalosë kujtimet e tij të veneruara nga një këndvështrim tjetër, **të përjetuara nga një inferioritet vandal**,..."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 7- 8)

8-13. LUFTA PËR FRONIN E LANDSHUT

Lufta për Fronin e Landshut-it ka qenë si një rezultat i një marrëveshjeje në mes qarqeve Bayern-Munchen dhe Bayern-Landshut. Marrëveshja ka pasë të bëjë me të drejtën e trashëgimisë nëse ndonjëri prej Kontëve vdes pa lënë ndonjë trashëgimtar nga linja mashkullore. Të dy këto qarqe kanë qenë prona të degëve të familjes *Das Haus Wittelsbach*, dhe në marrëveshje thuhet se nëse njëra degë shuhet nga linja mashkullore atëherë dega tjetër do t'i trashëgonte të dy qarqet. Me këtë marrëveshje, nuk merret parasysh ligji perandorak, sipas të cilit Perendori i shenjtë romak do t'i trashëgonte, nëse ndonjë linjë trashëgimie do të shuhej.

George, Kontit i Bayern-Landshut dhe gruas së tij Hedwig Jagiellon nuk u lindë një trashëgimtar nga linja mashkullore, kështu George e emërton të bijën e tij Elisabeth si trashëgimtare të tij. Duke u thirrur në marrëveshje, Konti Albert i Munihut nuk e pranon këtë, dhe kjo sjellë tek shpërthimi i luftës më 1503. Gjatë kësaj lufte dyvjeçare shumë fshatra rreth Landshut janë bërë shkrumb e hi, si ka qenë rasti me Ergolding.

Lufta ka përfunduar në vitin 1505 me vdekjen e Elisabeth dhe burrit të saj Ruprecht, Kont (Pfalzgraf) i Rhen, dhe një vendimi përmes arbitrimit të Perandorit Maximilian I, më 30 korrik 1505 në Tubimin e Këlnit (der Landtag von Köln).
Dy nipat e George, Otto Heinrich dhe Philip, e kanë marrë Pfalz-Nueburg (Junge Pfalz), një regjion i copëtuar nga *Ober Donau* përmbi *Franconia* deri tek pjesa veriore e *Oberpfalz*. *Neuburg an der Donau* zgjidhet si kryeqytet i shtetit të ri. Pasi dy trashëgimtarët nuk kishin arritur ende moshën madhore, Frederiku II, (Pfalzgraf) i Rhen, shërbej si regjent në regjimin kujdestar. Pjesa tjetër e territorit kalon në pronësinë linjës së Munichut të Shtëpisë Wittelsbach. Perandori e merr për vete territorin rreth Kufstein si shpërblim për ndërmjetësimin e tij pajtues, qyteti perandorak Nürnberg merr disa pjesë të rëndësishme në lindje të qytetit, duke përfshi këtu rrethet Lauf, Hersbruck dhe Altdorf. Si Kont (Pfalzgraf) Otto Heinrich shpenzoi shuma të mëdha parash për të ndërtuar pallate në Neuburg an der Donau. Përmes trashëgimive ai bëhet *Kurfürst*, dhe ndërtimet e tij nga Ottoheinrichsbau deri tek Kështjella e Heidelbergut e bëjnë atë si një prej ndërtuesve më të rëndësishëm të Renesansës Gjermane.

Nuk më ngeli gjë tjetër veçse t'i përfillja urdhrat e zonjës së shtëpisë

Shkolla e UDB-së: "***Edhe pas propozimit tim që të formohej një organizatë e ngjashme** politike e mos të bëheshin përpjekje për ta zëvendësuar atë që ishte e pamundur, nuk më ngeli gjë tjetër veçse t'i përfillja urdhrat e zonjës së shtëpisë...*" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Përsihtinë 2010, faqe 88)

8-14. LUFTA PËR FRONIN E INKAS

Lufta për Fronin e Inkas, Lufta e Dinastive të Inkas, Lufta Civile e Inkas, apo nganjëherë edhe e quajtur Lufta në mes Dy Vëllezërve, është zhvilluar në mes dy vëllezërve, Huáscar dhe Atahualpa, bij të Huayna Capac, lidhur me atë se kush do të ulet në fronin e Inca. Lufta ka pasuar pas vdekjes së Huayna Capac në vitin 1527, megjithëse nuk filloi para vitit 1529, dhe ka zgjatë deri më 1532. Huascar e ka filluar luftën pasi ai e ka konsideruar veten si trashëgimtar legjitim të krejt mbretërisë së Inkas. Pamvarësisht legjitimitetit Atahualpa u tregua taktikisht, në pikëpamje luftarake, shumë më i zoti se vëllau i tij tij dhe ato armata të fuqishme që Cuzco, babai i tyre i kishte stacionuar në veri, gjatë fushatës ushtarake.

8-15. LUFTA PËR FRONIN E PORTUGALISË

Lufta për Fronin e Portugalisë është zhvilluar në vitet1580-1583 në mes dy kërkuesve kryesor të Fronit: Antonios (Prior of Crato), i cili është proklamuar në shumë qytete si mbret i Portugalisë, dhe Filipit II të Spanjës, i cili faktikisht ka sukses në marrjen e kurorës mbretërore dhe qeverisi si Filipi I i Portugalisë.

Kurrë nuk e mora vesh pse Lëvizja e Jusuf Gërvallës dhe Zëri i Jusuf Gërvallës i përballuan në mënyrën më të fuqishme atentatit kundër Jusuf Gërvallës më 17 janar 1982:

-A ishte kjo meritë e inferioritetit të Frontit Popullor?!
-A ishte kjo meritë e inferioritetit të Frontit të Kuq të UDB-së?! apo
-A ishte kjo meritë e inferioritetit të Partisë "Komuniste" të Shkollës së UDB-së Serbe?!

8-16. LUFTA PËR FRONIN E POLONISË (1587-88)

Lufta për Fronin e Polonisë apo edhe Lufta Habsburgo-Polake është zhvilluar në vitet 1587-1588 rreth zgjedhjes së monarkut pas vdekjes Stephen Báthory, Mbret i Polonisë dhe Konti i Madh (Grand Duke) i Lituanisë. Luftimet janë zhvilluar në mes fraksioneve të Sigismundit III dhe Maximilianit III, pas të cilave Sigismundi kurorëzohet si Mbret i Polonisë dhe si Duka i Madh i Lituanisë. Në kuadrin e dy betejave kryesore të këtij konflikti hynë Rrethimi i Kraków-it, me ç'rast Maximiliani III dështon në pushtimin, marrjen e kryeqytetit të bashkësisë së shteteve (the capital of the Commonwealth), dhe Lufta e Byczyna-s, në të cilën Maximiliani detyrohet të kapitulloj. Fitorja e Sigismundit ka qenë pothuajse, në mënyrë vendimtare, vepër e *Chancellor and Hetman Jan Zamoyski,* i cili ka qëndruar si prapa intrigave politike ashtu dhe fitoreve ushtarake në këtë konflikt.

8-17. LUFTA PËR FRONIN E JÜLICH-UT

Lufta për Fronin e Jülich-ut apo Lufta e Jülich-Cleves ka qenë një konflikt politik dhe ushtarak, kryesisht i përbërë prej një serie rrethimesh dhe pushtimesh në mes Wolfgang William, Kont i Pfalz-Neuburg-ut, i përkrahur nga Spanja dhe Liga Katolike (nga viti 1613), John Sigismund - *Kurfurst von Brandenburg*, i përkrahur nga Provincat e Bashkuara dhe Mbretëria e Anglisë dhe Rudolph II - *Holy Roman Emperor* i cili tërhiqet nga kërkesa e tij në vitin 1610) për kontrollimin e Qarqeve të Bashkuara (the

United Duchies of Jülich-Cleves-Berg) që ka filluar në vitin 1609 dhe ka përfunduar më 12 nëntor 1614, me nënshkrimin e Traktatit të Xanten. *Jülich-Cleves-Berg* është ndarë në mes Kontit *Wolfgang William von Neuburg* dhe *John Sigismund von Brandenburg.*

Vrasja e tyre kishte këtë qëllim të mbrapshtë

Hasan Mala: *- Me sa di unë dhe nuk besoj se gabohem, u arrit vetëm në ditët e fundit të jetës së Kadri Zekës dhe Jusuf e Bardhosh Gërvallës. Ata u takuan disa herë në qytete të ndryshme të Gjermanisë, - më në fund në Shtutgart - dhe, më në fund, u morën vesh jo vetëm që të dyja organizatat të shkriheshin në një, por kështu të bëhej edhe me të dyja organet që botonin ato, përkatësisht 'Liria' dhe 'Zëri i Kosovës'. Të kishte pra vetëm një gazetë, dhe ajo të quhej* ***'Liria'****. Dhe Taip Zeka ka të drejtë kur mendon se ata qëndruan edhe një natë së bashku, për t'iu gëzuar në njëfarë mënyre, këtij bashkimi të shumëpritur. Dhe vrasja e tyre kishte pikërisht edhe këtë qëllim të mbrapshtë, të pengonte me çdo kusht dhe me çdo mjet bashkimin e organizatave dhe krijimin e* ***Frontit****, gjë që ndodhi realisht."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009, faqe 256-257)

8-18. LUFTA PËR FRONIN MANTUAN

Lufta për Fronin Mantuan (1628-31) ka qenë një pjesë periferike e Luftës Tridhjetëvjeçare. Shkaku i kësaj lufte (casus belli) ka qenë shuarja e linjës direkte mashkullore e Shtëpisë Gonzaga (the House of Gonzaga) në dhjetor 1627.

Vëllezërit Francesco IV (1612), Ferdinando (1612-1626) dhe Vincenzo II (1626-1627), vdesin të gjithë pa lënë trashëgimtar legjitim. Luftimet janë zhvilluar në mes përkrahësve të pretenduesve rival, Francës dhe Habsburgëve në një garë për ta kontrolluar Italinë Veriore.

8-19. LUFTA PËR FRONIN E PFALZIT (Der Pfälzische Erbfolgekrieg 1688–1697)

Lufta për Fronin e Pfalcit, e njohur si Lufta Nëntëvjeçare, quhet shpesh edhe Lufta e Aleancës së Madhe, ose edhe Lufta e Ligës së Augsburgut, ka qenë një luftë e madhe në fund të shekullit të XVII, që është zhvilluar në mes mbretit Luigjit XIV të Francës, dhe një koalicioni të gjerë Evropian, Alenacës së Madhe (the Grand Alliance), e udhëhequr nga the Anglo-Dutch Stadtholder-Mbreti William III, Kajzerin Leopold I, Mbretin Karl II të Spanjës, Victor Amadeus II të Savojës, dhe princa të mëdhenj e të vegjël të *Heiliges Römisches Reich (the Holy Roman Empire).*

Betejat e Luftës Nëntëvjeçare janë zhvilluar kryesisht në Evropën kontinentale dhe në ujërat rrethuese, por në teatrin e saj janë përfshi edhe Irlanda e Skotlanda, ku Vilhelm III dhe James II kanë luftuar për kontroll të Ishujve Britanik, dhe një fushatë (Lufta e Mbretit William) në mes kolonëve francez dhe anglez dhe përkrahësve të tyre gjegjës indianë në Amerikën Veriore koloniale. Kjo Luftë ka qenë e dyta, prej tri luftërave të mëdha të Luigjit XIV.

